

Edukimi i Fëmijëve

Eckhard Neumann

12

Studime të Shkurtra Biblike

ϕ_x^2

(

Edukimi i Fëmijëve

nga

Eckhard Neumann

Përktheu: Etleva Lala

Shtëpia botuese "Joshua,"

(

Adresa e porositjes:
Bashkësia e Jezusit
Kutia Postare 1
Elbasan / Albania

Shtëpia botuese Joshua
pranë Misionit të Krishterë Josua e.V.
Berlin

Titulli i originalit: Eckhard Neumann, Kindererziehung

Botimi i parë, 2002

PËRMBAJTJA

Hyrje	6
1. Parimi i kënaqësisë	7
2. Konsekuenca	10
3. Të mësosh bindjen	12
4. Të mësosh fëmijët	18
5. Të kesh kohë për fëmijët	24
6. Të diskutosh gjithçka së bashku	26
7. Të mos preferosh një fëmijë më shumë se sa tjetrin.	30
8. Udhëheqja në shtëpi	33
9. Të mësosh fëmijët të mbajnë përgjegjësi	35
10. Fazat në jetën e fëmijëve	37
Edukimi i bebeve/fëmijëve të vegjël	37
Edukimi i fëmijëve më të rritur	41
Përfundim	46
Dëshmi personale (nga Kirstin Gross)	47

(

HYRJE

Fëmijët janë dhuratë e bekuar nga Perëndia, një dhuratë e çmuar, në kohën e caktuar. Është fat të kesh fëmijë. Për njerëz që e njohin Jezusin dhe dëshirojnë të mësojnë, vetëm Bibla mund të jetë shembull në çeshtjen e edukimit të fëmijëve. Ajo ka thëniet dhe dëshmi shumë të qarta për pyetje thelbësore. Megjithatë, jo të gjitha pyetjet e hollësishme kanë zgjidhje të drejtpërdrejtë në Bibël. Për pyetje të tilla, Bibla jep parime të qarta dhe të bekuar nga Zoti, përdorimi i të cilëve për pyetje të veçanta, mund të sjellë rezultate të mrekullueshme.

Bibla nuk njeh parimet e edukimit antiautoritar dhe demokratik që janë të njohura sot në botë. Këto parime janë të huaja për fjalën e Perëndisë, prandaj i dashur lexues, ti nuk do t'i gjesh ato këtu, megjithëse shumë njerëz në kohën tonë flasin dhe shkruajnë për to. Ti nuk do të gjesh këtu as stilin e edukimit demokratik që diskutohet e praktikohet shumëkund.

Ne jetojmë në kohët e fundit. Jezusi do të vijë së shpejti. Si një shenjë të këtyre kohëve që do të janë të veshtira, Pali në letrën e dytë të Timoteut 3,1-2 thotë ndër të tjera, që njerëzit do të janë “të pabindur ndaj prindërve”. Pikërisht në këto kohë jetojmë edhe ne.

Kur unë dhe gruaja ime u martuam, më 1956, planifikuam që ta drejtonim martesën dhe familjen tonë sipas fjalës së Perëndisë. Megjithëse nuk kishim seminare, konsultime, libra ose kaseta për temën e martesës, të fëmijëve dhe edukimit, ne jemi përpjekur që të ecim sipas vullnetit të Perëndisë edhe në këto çeshtje. Fryma e Shenjtë erdhi për të na ndihmuar në pamundësitetona. Sot, ne mund të themi me plot gojën, që të katër fëmijët tanë, na duan me gjithë zemër dhe ecin me Jezusin. Deri tani (1997) Perëndia na ka dhuruar dhjetë nipër dhe mbesa. Ne jemi një familje e lumtur; jo pa shqetësimë, por e lumtur në Jezusin.

Perëndia e mbështet edukimin e mirë, pasi Ai u kujdes që Jezusi të rritet shumë mirë në Nazaret. Nga mënyra se si Jezusi jetoi tre vjet të shërbësës, se si i drejtoi dishepujt e tij, se si i pranonte te varfërit etj., kuptojmë që Maria dhe Jozefi kishin qenë prindër të mirë, që e edukuan atë për të qenë një njeri i shkathët në jetë. Gjatë këtij studimi, do të kthehem përsëri në këtë pikë.

1. PARIMI I KËNAQËSISË

Një nga parimet e ditëve tonë, është pak a shumë kështu: “Bëj çfarë të jep kënaqësi, çfarë të pëlqen, çfarë të ka ëndë”. Këngët dhe hit-et shprehin të njëjtën gjë. “Ne jetojmë në liri dhe nuk na pëlqen që të na vënë kufij. Kush është ai që guxon të na thotë se çfarë të bëjmë dhe çfarë jo?” Ky është parimi i kënaqësisë totale. Nëpërmjet një të menduarit dhe të vepruarit të tillë, përfat të keq, shpesh bëhen edhe shumë të këqija. “Fëmijët tanë janë të lirë të bëjnë gjithçka që dëshirojnë. Ne nuk mund t'i detyrojmë ata. Nuk mund t'i lëndojmë ata. Fëmijët e dinë vetë se çfarë është e mirë përtat. Ne nuk mund t'i privojmë ata nga asgje.” Edhe në vetë bashkësitet e krishtera, janë futur mendime të edukimit sipas parimit të kënaqësisë. Kështu, fëmijët mund të vendosin vetë se kur duan të shkojnë në shtrat dhe kur jo, kujt t'ia japin dorën kur shkojnë përvizitë dhe kujt jo, sa kohë mund të shohin televizor, etj. Ata janë bërë “zotërit” e kohës sonë. Prindërit i lusin ata me fjalë dashamirëse që t'u binden. Është shumë e fortë frika se fëmijët mund të lëndohen, nëse u ndalohet ndonjë gjë. Por, çfarë thotë Bibla përkëtë?

Zoti, krijuesi, që në fillim u ka dhënë njerëzve gjëra të mrekullueshme me veprat e Tij, por njëkohësisht, u ka vënë edhe kufijtë. Ai u dha të dy njerëzve një kopsht të mrekullueshëm, një vend të gjerë e të pafund plot me pemë e me fruta fantastike, gëmusha, fusha, kafshë, një lumë me katër degë kryesore dhe shumë gjëra të tjera. Njeriu kishte një liri pafundësish të madhe, por me një kusht të vetëm. Tek Zanafilla 2, 16-17a mund të lexojmë:

Dhe Zoti Perëndi e urdhëroi njeriun duke i thënë: “Ha bile lirisht nga çdo pemë e kopshtit, por mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes...”

Satani e përdori menjëherë këtë kufizim (Zanafilla 3) dhe i futi njerëzit në rrugë të gabuar. Satani e bindi Evën që ta kapërcente kufirin. Ky kapërcim kufiri = mëkatit, pati pasoja të tmerrshme. Urdhërimet e Perëndisë nuk mund të shkelen kaq lehtë. Tek Fjalët e Urta 3, 11-12 mund të lexojmë

se si Zoti na bekon kur ne ecim në rrugët e Tij:

Biri im, mos e përcmo ndëshkimin e Zotit dhe mos urre qortimin e tij, sepse Zoti qorton atë që do, si një baba djalin që atij i pëlqen.

Tani diçka shkurt për të ashtuquajturit stile të edukimit:

Stili antiautoritar - i ashtuquajturi stili Laissez-Faire¹, ishte në fuqi të plotë deri në fund të viteve '70. Më vonë ai u zëvendësua me stilin demokratik. Vetëm pak institucione edukimi e praktikojnë akoma sot edukimin antiautoritar. Sipas "Praktikës së dinamikës së grupeve", të autorit Klaus Anton (publikuar nga shtëpia botuese Hegrefe), përkrahët edukimi antiautoritar dhe shpirtgjërësia e praktikuar atje, që duket se është absolute madje mund të quhet një indiferentizëm i dyshimitë i udhëheqësve. Atje janë vënë re konkluzionet e mëposhtme:

- Pasoja: hutimi, pasiguria, pak prodhimtari
- Rezultati: Ky stil nuk është "efektiv në asnje pikëpamje"
- Nga kjo rrjedh një "acarim për shkak të mungesës së drejtimit"

Përbledhje:

Një udhëheqës duhet të jetë në gjendje "të marrë vendime, të zgjidhë konflikte, të vendosë qëllime, etj".

Kjo literaturë aplikohet në arsimimin profesional të infermierëve në spitalin Virchow në Berlin, në lëndën e psikologjisë. Edukimi antiautoritar nuk vlerësohet pozitivisht.

Në stilin e edukimit demokratik, i gjithë theksi vihet në mjete të tillë edukative, si lavdërimi, inkurajimi dhe përkrahja e përvojave të suksesshme, ndërkohë që qortimi, dënim i dëshiruar, dënim i paralajmërimi refuzohen plotësisht. Por, si mund t'i arrijmë qëllimet e edukimit të fëmijëve si "pjekuri, aftesi për të gjykuar, etj" me anë të këtyre metodave?

Është e padiskutueshme që media ka ndikim në opinionin e përgjithshëm të popullit. Është për t'u gëzuar që krahas mendimeve negative, ekzistojnë

edhe mendime pozitive, që shprehen për temën e edukimit të fëmijëve. Kështu p.sh., në revistën “Fernsehwoche” nr. 7/1997, faqe 16, në rubrikën “Histori e vërtetë”, mund të lexosh këshilla për një çift të cilët thonë se kanë një fëmijë shkatarraq, që po u shkatërron jetën familjare. Këshillat për çiftin, janë si vijon:

- Fëmijët kanë nevojë për kufij të formuluar qartë (shpesh është më mirë një “sepse nuk dual”, sesa një sqarim i stërgjatë.)
- Prindërit duhet të jenë në një mendje
- Fëmijët kanë nevojë për “ndalohet”
- Prindërit duhet të qëndrojnë gjakftohtë

Këto parime korrespondojnë edhe me mendimet biblike. Pra, Bibla nuk e njeh edukimin antiautoritar dhe stilin e edukimit demokratik, madje na paralajmëron për pasojat e ketij edukimi.

¹ “Lëre të bëjë” (shënim i përkthyesit)

2. KONSEKUENCA

Fjala më e rëndësishme që duhet mbajtur parasysh në edukimin e fëmijëve është konsekuencia. Me konsekuencë do të kuptojmë një edukim të mirë të fëmijëve. Pra, fjala që thuhet, është me të vërtetë një fjalë që do të praktikohet edhe nga prindërit, edhe nga fëmijët. Fjala jote duhet të jetë fjalë burri dhe ti duhet të ngulësh këmbë tek ajo që ke thënë. Kështu kemi bërë edhe ne në martesën tonë.

Gruaja qëndron normalisht më gjatë me fëmijët sesa burri, prandaj edhe ka më shumë përjetime me ta. Si bashkëshort, unë i kam thënë gruas time: Mendohu para se t'i kërcënosh fëmijët me ndonjë dënim, sepse pasi ta kesh thënë atë, atëherë duhet ta zbatosh, madje edhe po të të vijë keq. Kjo kuptohet që vlen edhe për premtimet kundrejt fëmijëve.

Sigurisht që babai apo mamaja janë gjithmonë në rrezik për të thënë diçka të nxituar, por për gabimin e fëmijës duhet menduar mirë se me çfarë dënim i ta kërcënosh. Dënim i me të cilin është kërcënuar fëmija, duhet zbatuar patjetër, me qëllim që ai të mësojë që fjala e prindërve, zbatohet vërtet. Ja një shembull ngajeta jonë:

Në familjen Neuman ishte zakon që të dielën e katërt para Krishtlindjeve, gjithmonë kishte një dhuratë të vogël surprizë, si p.sh. një lepirëse, ose një çokollatë. Kjo ishte diçka shumë e vogël, sepse në atë kohë ne kishim shumë pak para. Dhoma ishte e zbukuruar si për festë dhe fëmijët gjëzoheshin shumë për këtë. Ata mezi prisin të shikonin se çfarë surprize do të kishte. Megjithatë, fëmijët tanë gjëzoheshin shumë më tepër për mbrëmjen, sepse në mbrëmje kishte një festë të vogël në familje. Fëmijët dhe prindërit uleshin së bashku tek “dhoma e mirë” dhe festonin. Aty lexoheshin histori, luheshin lojëra. Mbrëmja vazhdonte gjëzueshmë dhe plot humor, deri në fund. Mbrëmje të tillë ishin gjithmonë të bukura dhe shumë të mirëpritura përfëmijët.

Kur unë hyra në “dhomën e mirë”, e cila në dimër ngrohej dhe përdorej vetem të dielave, pasqë që vajza jonë, Dorotea, që ishte shumë sportive, ishte ulur mbi pllakën e stufës. Unë e qortova: “Ulu shpejt poshtë!” Ajo u ul poshtë menjëherë dhe unë i thashë: “Nëse ti do të ngjitesh përsëri mbi stufë, nuk do të marrësh pjesë në festë”. Kur u futa në dhomë, disa minuta

më vonë, pashë që Dorotea ishte ulur përsëri mbi stufë. Tani, unë si baba isha i detyruar që të veproja. E urdhërova që të ndërrohej menjëherë dhe të shkonte në shtrat. Ajo qante me dënësë. Në darkë, pasi kishim filluar festën pér të cilën gëzoheshin të gjithë, dëgjoheshin akoma të qarat e Dorotesë, përtej dy dyerë të myllura. Ajo qante zemërcopëtar dhe mua më vinte shumë keq. Por ne e kishim vendosur këtë dhe duhej që ta mbanim fjalën. Ky ishte pér të një mësim pér gjithë jetën dhe madje jo vetëm pér të, por edhe pér të tre fëmijët e tjerë: Fjala e prindërve kishte patur vërtet peshë. Në fakt, ne na kishte ikur dëshira pér të festuar, por megjithatë, ishte e rëndësishme që fëmijët e mësuan këtë. Pse ishte kaq e rëndësishme kjo gjë? Ne kemi kuptuar që kur fëmijët mësojnë ta marrin seriozisht fjalën e prindërve, atëherë mund ta marrin seriozisht edhe fjalën e Perëndisë. Përkundrazi, kur ata nuk i kushtojnë rëndësi fjalës së prindërve, atëherë e kanë të vështirë që të pranojnë si autoritet edhe fjalën e Perëndisë. Prindërit janë pér fëmijët “përfaqësuesit” e dukshëm të Jezusit në tokë. Tek prindërit, fëmijët shikojnë se ç’do të thotë të ecësh me Jezusin, të besosh, të lutesh dhe të kalosh një jetë me Zotin. Fëmijët imitojnë atë që shikojnë tek prindërit. Kështu, fëmijët do të mendojnë se fjala e Perëndisë është e sigurt, qëndron fort dhe nuk lëkundet.

Për fat të keq, duhet të themi që ka edhe prindër që vetëm flasin, flasin e flasin. Për shkak të këtij inflacioni fjalësh, fëmijët nuk i marrin aspak seriozisht ata dhe nuk i dëgjojnë fare. Vetëm kur prindërit e ngrenë zërin, atëherë fëmijët ngrenë kokën duke e ditur që përveç fjalëve nuk ka asnje veprim. Kjo i acaron tmerrësisht prindërit dhe edukimi i fëmijëve nuk ka asnje rezultat. Përkundrazi, prindërit dështojnë dhe fëmijët kanë vështirësi pér të marrë seriozisht fjalën e Perëndisë. Ne duhet të themi me gjëzim se të katër fëmijët tanë e kanë marrë seriozisht fjalën e Perëndisë dhe jetojnë me Jezusin. Po kështu, është e rëndësishme që para fëmijëve të mos mbrosh një mendim të ndryshëm nga bashkëshorti apo bashkëshortja. Përkundrazi, prindërit duhet që të bashkëveprojnë dhe të janë gjithmonë me të njëjtin mendim. Ne kemi parë se si fëmijët tanë janë përpjekur që të na ngrenë kurthe. Një ditë, erdhi një nga fëmijët tek unë dhe më pyeti nëse i lejohej që të bënte diçka dhe unë e lejava. Pak më vonë, vjen gruaja dhe më thotë me qortim: “Unë ua kam ndaluar këtë gjë fëmijëve pér këto arsy...” Me sa më

kujtohet, kjo na ka ndodhur vetëm një herë. Herën tjetër, kur në një situatë të njashme, fëmijët kerkuan leje, unë u përgjigja me një pyetje: “Çfarë thotë mamaja pér këtë?” dhe doli që mamaja e kishte ndaluar atë gjë. Natyrishq që përgjigjja ime ishte: “Mendon ju se unë do t’ju them diçka të ndryshme nga mamaja?” Që prej asaj dite, fëmijët nuk u përpoqën më kurre që të na ngrin kurthe, sepse e dinin që fjala e të dy prindërve ishte e njëjtë.

Ne nuk na duket e drejtë që t’u japid shpjegime fëmijëve, p.sh. pse ata duhet të bëjnë punë të caktuara. Megjithatë, kjo mund të bëhet kur fëmijët arrijnë në moshën e adoleshencës. Në fillim, është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë të veprojnë sipas një fjale, pa u sqaruar me hollësi pér rëndësinë e punës. Në fillim, ata duhet të veprojnë sepse kështu ka thënë mama apo babai. Kjo duhet që t’u mjaftojë atyre.

3. TË MËSOSH BINDJEN

Bindja është diçka që duhet të mësohet. Fëmijët nuk janë të bindur vvetveti, prandaj bindja duhet t’u mësohet atyre. Që në Testamentin e Vjetër, Perëndia e ka vendosur këtë në urdhërimet e Tij. Ai instruktoi Abrahamin, babain e besimit, se si të sillej me familjen e tij. Ne lexojmë këto vargje tek Zanafilla 18, 19:

“Unë në fakt e kam zgjedhur (Abrahamin), me qëllim që të urdhërojë bijtë e tij dhe shtëpinë e tij që të ndjekin pas tij rrugën e Zotit, duke zbatuar drejtësinë dhe barazinë, në mënyrë që Zoti të mund të plotësojë premtimet që i ka dhënë Abrahamin”.

Një varg shumë i quartë dhe domethënës. Abrahami duhej që të urdhëronte fëmijët dhe shtëpinë e tij që të ecnin në rrugën e Zotit, që të bënин gjërat e Zotit, që të ishin të bindur dhe të bënин atë që ishte e mirë dhe e drejtë në

sytë e Zotit, me qëllim që premtimet për familjen e tij të realizoheshin. Dhe Abrahami ishte me të vërtetë babai i besimit, një burrë që i bindej menjëherë Perëndisë kur Ai i thoshte ndonjë gjë. Kjo e karakterizoi të gjithë jetën e tij. Abrahami nuk ishte pa të meta, por ai ishte babai i besimit dhe i bindjes dhe gjithashtu edhe një shembull i mirë për ne. Edhe në Testamentin e Ri mund të lexojmë herë pas here, se si Perëndia kërkon që ne të jemi të bindur përkundrejt prindërve. Tek Efesianët 6:1,4 mund të lexojmë:

Fëmijë, binduni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë... Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit.

Zoti pret që prindërit t'ua mësojnë bindjen fëmijëve të tyre nëpërmjet disiplinës dhe paralajmërimeve. Ai i paralajmëron fëmijët që të janë të bindur ndaj prindërve.

Edhe prindërve, sidomos baballarëve, u thuhet që të mos i provokojnë fëmijët me zemërim. Nga kjo bëhet e qartë, se pse është burri ai që vë kufijtë në edukimin e fëmijëve, në martesë. Kjo do të thotë që ai do të vendosë në harmoni me bashkëshorten e vet, se brenda çfarë kufijsh lejohet që të lëvizë fëmija. Kështu, burri duhet të thotë fjalën e fundit si p.sh. në çështje të tillë: "Sa kohë lejohet fëmija që të luajë jashtë me shokët e tij? Kur duhet të jetë në shtëpi? Me cilët fëmijë duhet të rrijë? Cilat pretendime janë të peshuara dhe cilat të tepruara? (lodra, biçikleta, rroba etj)." Kështu pra, ka një mori gjërrash për të cilat prindërit duhet të janë në harmoni me njëri-tjetrin, çështje për të cilat burri, si kreu i familjes, duhet të thotë fjalën e fundit.

Natyniqt që Jezusi është në të gjitha gjërat, shembull për ne. Edhe atij iu desh që si njeri, të përshtatej me shoqérinë e familjes dhe të mësonte të bënte gjëra të caktuara. Tek Hebrejtë 5, 8 lexojmë që Jezusi e mësoi bindjen. Edhe Biri i Perëndisë, pra, duhet ta mësonte si njeri, bindjen. Po kështu, atij iu desh të mësonte që t'u përulej prindërve të tij, Marisë dhe Jozefit. Ne mund të lexojmë më poshtë për dymbëdhjetëvjeçarin Jezus, që kishte qenë në tempull dhe po kthehej me prindërit e tij nga Nazareti (Luka 2, 51-52):

Dhe ai zbriti bashkë me ta, u kthye në Nazaret dhe u bindej atyre. E ëma i ruante të gjitha këto fjalë në zemrën e saj. Dhe

(

Jezusi tritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve.

Kur po mendoja për këtë, pyeta veten: "A i duhej Birit të Perëndisë që të kërkonte mençuri dhe hir nga Zoti, Babai i tij, gjatë qëndrimit mbi tokë, në mënyrë që të mund t'u nënshtrohej prindërve të tij tokësorë, Marisë dhe Jozefit?" Bibla e pohon këtë pyetje. Edhe Jezusi vetë mësoi që t'u nënshtrohej prindërve të tij tokësorë në mënyrë vullnetare dhe bëri atë që i thonin ata. Kështu, edhe në këtë pikë, Jezusi është një shembull për ne. Ai mësoi shumë gjëra të mira, gjëra të cilat mundi t'i praktikonte më vonë kur filloj shërbimin e tij që të udhëhiqte dishepuj. Ai ishte një udhëheqës i mirë për ta. Ai kishte mësuar nga Jozefi.

Në familjen e Tij të madhe (sipas Mateut 13, 55-56, familja e Tij numëronte të paktën 9 persona) dhe në zdrukthtarinë e të atit, Jezusi kishte mësuar edhe të kursente. Kjo bëhet e qartë, kur gjatë shpërndarjes së ushqimit për 4500 vetë, ai i numëroi koshat që ishin mbushur me bukën e tepruar dhe për këtë mbajti një predikim për dishepujt e tij. Kjo të çon në përfundimin që kursimi ishte një gjë e zakonshme në shtëpinë e Jozefit. Po kështu, Ai duhet të ketë mësuar në shtëpi, që të jetonte pa zili, sepse njëherë, kur dikush erdhi dhe i tha që një person tjetër që nuk ishte në skuadrën e Jezusit, po përzinte demonë dhe që dishepujt ia kishin ndaluar këtë gjë atij, Jezusi tha që ata nuk duhet ta kishin bërë këtë gjë. Jezusi pra, ishte i lirë nga mendimet ziliqare. Për Sabat, Jozefi e çonte gjithmonë familjen e tij në sinagogë. Edhe më vonë, Jezusi shkonte në sinagogë, si për të predikuar, ashtu edhe për të qëndruar në tempull. Kur e pa që nuk po e dëgjonin, ai shkoi nëpër vende të ndryshme si në male, në rrugë, etj. dhe predikonte atje.

Përveç kësaj, ai duhet të ketë mësuar në shtëpi që të hante të gjitha ushqimet që i servireshin. Me sa duket, fëmijët mësohen që kur ishin të vegjël që të hanin gjithçka. Është mirë kur ata mësojnë që të vlerësojnë të gjitha ushqimet dhe gjithashtu edhe i hanë ato. Në mision, kjo mund të jetë tepër e rëndësishme. Tek Luka 10, Jezusi dërgon të shtatëdhjetë e dy dishepujt e Tij në mision. Ai i dërgon ata që të shkojnë dhe të predikojnë fjalën e Zotit si edhe të bëjnë të gjitha ato gjëra për të cilat Ai i ka porositur. Ai thotë dy herë tek vargu 7 dhe 8, që ata të hanë gjithçka që do t'u jepet. Ndërsa e

përmend vetëm një herë porosinë shpirtërore, Ai e thekson dy herë rëndësinë e të ngrënët dhe të përit të gjithçkaje që do t'u vihej përpara. Këtë ne e kemi përjetuar vetë në mënyrë masive, në Pusta të Hungarisë, kur ishim një herë në një udhëtim me mision. Atje po na prisnin motrat dhe vëllezërit tanë hungarezë, të cilët kishin përgatitur një drekë para se të fillonim takimin. Ata vetë kishin ngrënë. Për drekë kishte pula të ziera, por atje ishte zakon që t'i zienin edhe kokat edhe këmbët e pulës bashkë me mishin tjeter. Për sytë dhe zakonet e gjermanëve, kjo nuk ishte aspak e këndshme. Kur ky ushqim na u shtrua mbi tavolinë, m'u bë e qartë se në qoftë se ne nuk do ta hanim këtë ushqim, nuk do të kishim sy e faqe që të predikonim më vonë. Ata nuk do ta pranonin fjalën tonë, nëse nuk do të hanim ushqimin e tyre. Më në fund hëngrëm. Nuk ishim të detyruar që të hanim patjetër një kokë apo një këmbë pule. Më vonë, në shërbesën e Zotit, ata na kushtuan të gjithë vëmendjen e tyre. Kështu pra, zoti Jezus i kishte vënë menjëherë lidhjet midis misionit dhe të ngrënët të gjithçkaje.

Shtëpisë tënde i mbetet vendimi nëse fëmijët e tu do të hanë këtë apo atë dhe nëse ata pëlqejnë vetëm diçka apo mësojnë të hanë gjithçka. Për fat të keq, në disa familje ndodh që fëmijët i thonë nënës: "Mami, këtë nuk dua që ta ha." dhe nëna i lë fëmijët të lirë që të hanë sipas dëshirës. Kjo nuk duhet të ndodhë.

Fëmijëve duhet që t'u mësohet bindja. Akoma më i qartë është mesazhi që na sjell shkruesi i letrës së Hebrenejve (Hebrenjtë 12, 5b-9):

Biri im, mos e përqmo qortimin e Perëndisë dhe mos e humb zemrën kur Ai të qorton, sepse Perëndia ndreq atë që do dhe fshikullon çdo bir që i pëlqen". Në qoftë se ju do ta duroni qortimin, Perëndia do t'ju trajtojë si bij; sepse cilin bir nuk e korigjon i ati? Por, po të mbeteni të pandrequr, ku të gjithë u bënë pjestarë, atëherë jeni kopila dhe jo bij. Pastaj etërit tanë sipas mishit i patëm për të na ndrequr dhe i nderonim ata; a nuk do t'i nënshtrohemë edhe më tepër Atit të shpirtrave, për të jetuar?



Bibla, këtu na e mohon dashurinë për fëmijët tanë në qoftë se ne nuk i edukojmë ata. Shpesh flitet vetëm për një anë të dashurisë: për të bërë të mirën, për të plotësuar dëshirat, për të dhënë dëshmi dashurie etj. Por, ana tjetër e dashurisë, është që t'i edukojmë fëmijët tanë. Pra, edhe një herë: Bibla na e mohon dashurinë për fëmijët nëse ne nuk i edukojmë ata. Kështu, prindërit kanë për detyrë që të marrin përsipër edukimin e fëmijëve në mënyra nga më të ndryshmet.

Fëmijët kanë një sens drejtësie në vetvete dhe vërejnë nëse prindërit janë konsekuentë ose jo. Për këtë, mund të lexosh tek Fjalët e Urta 20, 30 dhe 22, 15.

**Të rraturat që lënë plagë të thella e heqin të keqen,
ashtu si goditjet që vijnë në pjesën më të brendshme
të zorrëve.**

**Marrëzia lidhet me zemrën e fëmijës, por shufra e
korrigimit do ta largojë prej saj.**

S'kam për ta harruar kurrë një ngjarje me djalin tonë Andreas. Ishte e qartë që ai kishte bërë diçka të ndaluar. Kur unë i thashë (dhe sytë e tij shprehnin pikëllim kur më shikonte): “E di që duhet të të dënoj tanit?”, ai u përgjigj me zë të ulët: “Po babil!”

Pra, fëmijët kanë një ndjeshmëri të lartë për drejtësinë. Në qoftë se dënohen për një faj që kanë bërë, atëherë ata janë të qetë përbrenda dhe e dinë se çështja u mbyll me kaq. Ata kanë një barrë në ndërgjegje vetëm kur mbajnë me vete gjëra të fshehta prej vitesh, mëkate që i kanë bërë kur ishin fëmijë dhe që për ndonjë arsy apo ndonjë tjetër, të tjerët nuk i vunë re. Për këtë shkak, është e pakuptueshme për mua frika që kanë disa rrethe karizmatike se mos lëndojnë fëmijët kur i dënojnë ata. Ti nuk e plagos fëmijën tend nëse e dënon.

Njëherë, kur në një shkollë biblike për dishepuj, nxënësit treguan për lëndimet e tyre më të mëdha, një vajzë tha që ajo ishte e lënduar sepse mamaja e saj e ndarë nuk i kishte ndaluar kurrë ndonjë gjë. Kur një mbrëmje

vonë ajo kishte dashur të shkonte të rrëshqiste mbi borë, në errësirë, mamaja e kishte pyetur se ku do të shkonte dhe pastaj i kishte thënë: "Ah, bija ime, rri më mirë këtu!" "Por, unë dua që të shkoj patjetër!" i ishte përgjigjur ajo dhe mamaja ia kishte kthyer: "Epo mirë, shko atëherë!" Kështu, ajo kishte vajtur në pistën e rrëshqitjes në mal. Kur kishte arritur, ishte errësirë dhe asnje fëmijë nuk ishte më atje. Në atë errësirë, ajo ishte ndier krejt e pambrojtur nga e ëma dhe kishte filluar të qante me dënesë. Ajo na tregoi që ky kishte qenë lëndimi më i madh në jetën e saj, duke thënë se do të kishte dashur që mamaja t'ia ndalonte ca gjëra dhe në këtë mënyrë ta kishte mbrojtur më tepër. A e kuptojmë se çfarë do të thotë kjo për ne? Fëmijët dëshirojnë që të udhëhiqen. Edhe kur rebelohen në mënyrë të pavetëdijshme, kanë dëshirë që të mbrohen dhe të udhëhiqen. Ka një larmi të madhe mundësish edukimi. Ato duhet të përshtaten me karakterin dhe llojin e fëmijës.

Ishte një gjëzim i madh për ne kur djali i madh na tha një ditë: "Të dashur prindër, ju jam shumë mirënlohës që më keni edukuar në mënyrë kaq konsekuente. Ju keni vërejtur me kujdes p.sh. që unë të mos pi ja duhan. Të gjithë kolegët e mi të punës pijnë dhe shpenzojnë 60 deri 100 marka në muaj, vetëm për duhanin. Unë nuk e ndicj nevojën që të pi duhan. Në atë kohë, ju ma keni ndaluar në mënyrë kategorike dhe unë ju jam thellësishët mirënlohës për këtë. Në qoftë se ju nuk do të kishit qenë kaq konsekuente, kush e di se ku do të kisha përfunduar sot". Ky ishte një inkurajim shumë i madh për ne, sepse djali ynë është i martuar dhe ka vetë një vajzë.

4. TË MËSOSH FËMIJËT

Mënyra kryesore se si fëmijët mësojnë diçka, është nëpërmjet shembullit të prindërve. Fëmijët imitojnë gjithçka që bëjnë prindërit. Ja një shembull:

Ne nuk u kemi ngarkuar kurrë si detyrë fëmijëve tanë që t'a festojnë Krishtlindjen në familjet e tyre, ashtu siç e kemi festuar ne në familjen tonë. Megjithatë, ne shikojmë që fëmijët i festojnë festat në të njëjtën mënyrë siç i festonin me ne dikur: këndojnë këngë për Krishtlindjen, lexojnë historinë e saj, luten, dhurojnë, hanë diçka të veçantë, luajnë, etj. Për drekë hanë një lakër jeshile që quhet "lakra e Krishtit". Jeta jonë është bërë shembull edhe për fëmijët. Nëse babai është i sjellshëm me mamanë, e ndihmon atë që të heqë pallton, e ndihmon edhe për gjëra të tjera, atëherë edhe djali do t'i shërbejë më vonë gruas së tij po në të njëjtën mënyrë. Gruaja ime, Christel, gjithmonë është kujdesur për të moshuarit, i viziton ata, i pastron ose i ndihmon për gjëra të tjera. Për vite me radhë, ne kemi mbajtur pa pagesë në shtëpinë tonë, një vëlla nga bashkësia, gruaja dhe vajza 44-vjeçare e të cilit kishin vdekur dhe e kishin lënë krejt vetëm. Ne e ftonim atë çdo ditë që të hante bashkë me ne, megjithëse as vetë nuk kishim shumë, sepse fitonim fare pak para. Për Krishtlindje kishim, pra, këtë xhaxha të dashur, në shtëpi. Përveç atij, ne kishim të ftuar edhe disa motra dhe vëllezër të tjerë, të ve apo të veja, sepse nuk donim që ata ta kalonin Natën e Shenjtë vetëm.

Të gjithë fëmijët tanë japid me kënaqësi e me gjëzim dhe ata ftojnë gjithmonë për Krishtlindje, njerëz nga bashkësia. Në më të shumtën e rasteve, këta njerëz janë persona të vëtmuar, të cilëve duan që t'u japid pak dashuri.

Ajo që ne bëjmë me vepra, shpesh flet më shumë sesa ajo që themi. Megjithatë, duhet të përdorim edhe fjalët. Kështu, është e rëndësishme që ne të mësojmë besimin në familje. Tek Ligji i Përtërirë 11, 18:19 shkruhet:

Do t'i shtini këto fjalë në zemrën dhe në mendjen tuaj, do t'i lidhni si një shenjë në dorë dhe do të jenë si ballore midis syve;

do t'ua mësosh bijve të tu, duke u folur pér to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur rri shtrirë dhe kur çohesh;

Ky kapitull ka një mbishkrim në Biblën time: "Kujto veprat e mira të Perëndisë". Bëhet fjalë që me kalimin e kohës t'i mësosh fëmijët si të besojnë. Ja një shembull pér këtë:

Vajza jonë, Kornelia, kishte nevojë urgjente pér një xhakaventë pér në shkollë. Meqë ne nuk kishim para, i thamë që të lutej vetë dhe të besonte. Këtë gjë ajo e bëri me përkushtim të madh dhe madje edhe motrat e vëllezërët e tjerë e ndihmuani. Çdo mbrëmje ajo lutej pér xhakaventën e saj dhe i thoshte Perëndisë se i duhej patjetër një e tillë. Pasi kishin kaluar disa javë, një mbrëmje, më pyeti: "Babi, po sikur Zoti të mos e dëgjojë lutjen time?"

Kjo pyetje më shpoi thellë në zemër. Unë u mendova pak dhe pastaj i thashë: "E dashur vajzë, Zoti nuk do të të lërë në baltë, kështu që vazhdo të lutesh dhe të besosh!" Pak kohë më vonë, ne morëm një letër nga ish-Gjermania Perëndimore. Ne jetonim në Fürstenwalde të ish-Gjermanisë Lindore. Dikush na shkruante se mund t'u shprehnim një dëshirë dhe ata do të na e plotësonin. U përgjigjëm menjëherë dhe menduam se tani do të mund të ndihmonim në përbushjen e lutjes së Kornelias: "Në qoftë se nuk është shumë e shtrenjtë, ne do të dëshironim një xhakaventë të kësaj e asaj madhësie." Pas pak kohësh erdhi vërtet një xhakaventë, me postë, në Fürstenwalde. Për fat të keq ajo ishte shumë e madhe, kështu që ne e fshehëm pér t'ia dhënë Kornelias pér Krishtlindje. Por Zoti kishte planifikuar që edhe nëpërmjet kësaj gjëje të na mësonte diçka. Pak para Krishtlindjeve, erdhi një pako tjeter nga perëndimi (ky ishte vërtet një rast shumë i rrallë pér familjen tonë) dhe në të ishte një xhakaventë me përmasat e Kornelias. Ne as që i ishim lutar këtij dërguesi dhe as që ia kishim treguar përmasat e Kornelias. Dërguesi e kishte përgatitur pakon sipas udhëzimeve të Frymës të Shenjtë dhe e kishte dërguar. Ne e lavdëruam shumë Zotin dhe kuptuam se vetëm Ai është në gjendje që t'u përgjigjet lutjeve të fëmijëve. Ai na kishte dhënë edhe neve një mësim të jashtëzakonshëm duke e marrë seriozisht besimin e Kornelias dhe duke e forcuar atë.

Një shembull tjetër, të cilin e ka përjetuar po Kornelia, tregon për përkujdesjen plot dashuri të Perëndisë edhe atëherë kur bëhet fjalë për gjëra që nuk janë shumë të domosdoshme për jetën e përditshme. Si shumë vajza të moshës së saj, Kornelia dëshironte një karrocë kukulle. Ajo ishte një “mami kukulle” e apasionuar dhe i donte shumë ato. Meqë siç e përmendëm më sipër, ne nuk kishim para, i thamë: “Ti duhet të kursesh dhe të lutesh për karrocën e kukullës.” Të kursente, por çfarë?

Në kohën e Republikës Demokratike Gjermane, mund të ktheje mallra të përdorura si shishe, letra, rroba të vjetra dhe të merrje ca para për këtë. Kështu, Konelia filloi të bënte gjithçka që i vinte ndoresh për të mbledhur para të mjaftueshme për të blerë karrocën e kukullës. Më në fund, në kutinë e saj të kursimit, ajo kishte rreth 78 pfenig. Kornelia ishte shumë e lumtur. Por, kur pyeti nëse kjo shumë mjaftonte për të blerë karrocën e kukullës, na u desh që t'i thonim se duheshin edhe shumë para të tjera. Ajo përsëri ishte e gjuar dhe donte që të vazhdonte të kursente, duke u rezistuar madje, të gjitha tundimeve të tjera, kur p.sh. motrat dhe vëllezërit e tjerë e nxisin që të blinte ndonjë ëmbëlsirë që kushtonte 10 pfenig. Më pas, në bashkësi, do të organizohej mbledhja e parë e lëmoshave “Bukë për botën”. Meqë ne në familje flisnim për gjithçka, u treguan fëmijëve tanë që në botë ka fëmijë të cilët nuk kanë shtrat për të fjetur, që janë të detyruar të jetojnë në rrugë dhe se me anë të mbledhjes së lëmoshave “Bukë për botën”, synohej që t'u vihej në ndihmë atyre. Ata na dëgjonin me shumë vëmendje. Kur erdhì dita për mbledhjen e lëmoshave në bashkësi, për çudinë tonë të madhe, Kornelia kishte marrë me vete edhe kutinë e saj të kursimit. Ndërsa qesja e lëmoshave kaloi nëpër radhë, me një gjest të mrekullueshëm ajo i derdhë të 78 pfenig-ët e saj në të. Ne ishim shumë të prekur ngaqë ajo kishte dhënë gjithçka që kishte. Zotit duhet t'i ketë pëlqyer shumë ky akt sepse diçka shumë e veçantë ndodhi pas pak kohësh. Disa javë më vonë na shkruan një kushëri i largët, me të cilin pothuajse nuk kontaktonim më prej kohësh dhe na thotë se kishte një karrocë kukulle të përdorur, që nuk i duhej. Ai na pyeste nëse ishim të interesuar për të. Natyrisht që ne ishim të interesuar, kështu që iu përgjigjëm se do të dëshironim ta

kishim karrocën e kukullës. Kushërini tha se do ta sillte me tren. Ne, si prindër, kishim tani vetëm një gjë për të bërë: të luteshim që ajo të arrinte në kohën e duhur para Krishtlindjes. Për gjëzimin tonë të madh, ajo erdhi dy-tre ditë përpëra dhe ndërsa pema e Krishtlindjes shkëlqente nga qirinjtë, shkëlqenin edhe sytë e Kornelias kur panë karrocën e kukullës. Perëndia e merr shumë seriozisht besimin fëmijëror.

Meqë dy prej fëmijëve tanë ishin martuar dhe larguar nga shtëpia, me ne jetonte vetëm Andreas dhe Dorothea. S'kam për ta harruar kurrë një moment kur, të katërt, po luteshim për diçka të veçantë. Kur mbaruan së luturi, gruaja ime tha: "Mirë, por, po sikur kjo gjë të shkojë ters apo të mos plotësohet fare?" Djali ynë, Andreas, u përgjigj shumë energjikisht: "Mami, por ne u lutëm tani dhe besojmë që Perëndia i dëgjon lutjet tonë!" Ne, si prindër, heshtë mund të jenë partnerët tanë në besim. Këtë besim ndaj fëmijëve ne duhet që, së pari, ta ndërtojmë. Është rëndësishme që t'u tregojmë atyre se çfarë mund t'u ndodhë në shkollë, në mënyrë që t'i parapërgatisim për gjérat e pakëndshme që mund të ndeshin. Ata duhet të jenë të armatosur që të mund të reagojnë kundrejt sfidave, si p.sh. shprehjeve banale që do të dëgjojnë, ushtrimet meditative që bëhen në disa vende, horoskopëve apo gjérave të tjera që mund të hasin shpesh nëpër shkolla. Megjithatë, duhet t'u flitet edhe për anët e mira, si p.sh. për shoqërinë që do të krijojnë, si do të flasin për Jezusin, apo për gjëra të tjera.

Meqë ne i kishim mësuar fëmijët tanë që kur ishin të vegjël, që të luten vetë, dhe meqë ata kishin përjetuar përgjigje të lutjeve të tyre, nuk ishte problem që do të shkonin në një shkollë ku edukohej në mënyrë ateiste dhe që do t'u duhej të anëtarësosheshin si "Pionierë" dhe në "FDJ" (Organizata socialistë në të cilat duhej të merrnin pjesë të gjithë të rinjtë dhe fëmijët). Që më parë, ne u kishim thënë se mësuesit në shkollë do t'u mësonin se gjoja nuk ka Zot, por kjo nuk duhet të ishte problem për ta sepse e kishin përjetuar vetë që kjo nuk ishte e vërtetë. Edhe me organizatat e pionerëve nuk kishim problem sepse fëmijët nuk dëshironin që të bëhen anëtarë, as të organizatës së "Pionerëve" dhe as të "FDJ". Ata e dinin që atje, krahas

gjërave të mira, kishte edhe propagandë ateiste. Kështu ne i përgatitëm fëmijët edhe në këtë drejtim.

Na duket gjithashtu e rëndësishme që fëmijët të inkurajohen për një hapje të plotë ndaj prindërve, me qëllim që të mos u mbajnë sekrete atyre, por t'u thonë gjithçka. Natyrisht, kushti kryesor për këtë, është që prindërit të gjejnë vazhdimisht kohë për ta. Më pëlqen shumë kur nipi-erit tanë thonë ashtu siç thonin dikur fëmijët tanë: "Përveçse për Krishtlindje kur bëhet fjalë për dhurata, ne nuk kemi asnje sekret. Ia themi gjithçka njëri-tjetrit". Fëmijët duhet t'u thonë gjithçka prindërve, me qëllim që edhe më vonë, ata të mund të jetojnë një jetë të hapur me Perëndinë dhe të jenë të gatshëm që t'i pohojnë mëkatet e tyre para njerëzve dhe Perëndisë. Ky inkurajim për hapje dhe sinqueritet, është shumë i rëndësishëm nga këndvështrimi ynë, me qëllim që fëmijët të mësohen të mos e mbajnë ditë e natë me vete, barrën e rendë të mëkatit. Të gjitha mëkatet që qendrojnë në errësirë, bëjnë që ata t'i vrasë ndërgjegjja.

Vajza jonë, Dorothea, na tregoi një herë se si djali i saj, Johannesi, duke ndërprerë lojën, kishte vrapiuar tek ajo, për t'i treguar një mëkat të vogël që e kishte bërë disa ditë më parë. Ndërgjegjja e tij ishte kaq e rënduar, saqë ai kërkonte ta rrëfente menjëherë atë që kishte bërë. Për këtë shkak, marrëdhëniet e sinqerta dhe të hapura me njëri-tjetrin, janë shumë të rëndësishme. Dhe ju, të dashur prindër, nëse bëni ndonjë gabim kundrejt fëmijëve tuaj, nuk ka asgjë të keqe që më pas të thoni: "Ne kemi gabuar!" apo "Për këtë, e kemi ne fajin!"

Një pikë tjeter është që problemet e fëmijëve t'i sjellim së bashku me ta tek Perëndia. Ne nuk duhet të mendojmë: "Zoti nuk kujdeset për vogëlsira të tillë.", apo "Kjo është diçka e parëndësishme!". Perëndia i merr seriozisht problemet e fëmijëve, kështu që edhe ne duhet t'i marrim seriozisht ato. Mbështetje na vjen për të qeshur kur ata luten p.sh. për një fërguese elektrike. Një nga nipi-erit tanë iu lut Zotit për një fërguese të tillë dhe me sa di unë edhe prindërit u lutën bashkë me të. Ata u lutën kaq gjatë, saqë vërtet morën dhuratë një të tillë. Fëmijët kanë shqetësimë dhe nevoja krejt të ndryshme nga ato të të rriturve, por ata janë të vlefshëm për Perëndinë. Thjesht, le të mendojmë se sa mirë shkonte Jezusi me fëmijët, se si i

vlerësonte Ai ata dhe se si thoshte që engjëjt e tyre shikojnë vazhdimisht fytyrën e Perëndisë në qiell. (Mateu 18,10). Madje, në vargun 3 të Mateut 18, Ai thotë:

Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërini e qiejve.

Ai edhe i bekoi fëmijët. Ata ishin shumë, shumë të rëndësishëm për Të. Fëmijët tanë janë brezi pasardhës, në qoftë se Jezusi nuk vjen më parë. Për këtë shkak, duhet të sillemi në mënyrë të tillë që të mbrojmë besimin e fëmijëve dhe t'i ndihmojmë ata që të bëjnë gjërat e Perëndisë.

Së fundi, duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë edhe gjëra praktike. Për mua kjo ka qenë një gjë e madhe. Për këtë arsy unë e merrja me vete në punë, djalin tonë, Andreasin. Puna ecte shumë më ngadalë se sa po ta kisha bërë vetë të gjithën, por për mua ishte e rëndësishme që ai të mësonte.

Është shumë e rëndësishme se çfarë do të përfitojnë të tjerët nga fëmijët e tu, sepse ata përfaqësojnë familjen tënde në shoqëri. Si paraqiten ata në shoqëri? Kur babai shan shumë, atëherë fëmijët do të thonë në rrugë, që në familje ka zënka. Po kështu do të thonë kur mamaja është me humor të paqëndrueshëm. Por ata mund të thonë edhe kështu: "Ne lutemi për gjithçka në shtëpi dhe përjetojmë mirësinë e Perëndisë". Kur ti udhëton me fëmijët e tu, a i mëson që të ngrihen kur ka të moshuar në këmbë, me qëllim që t'i nderojnë ata? Shembulli i mirë i nënës dhe i gjyshes së Timoteut ishte kaq i rëndësishëm për të, saqë Pali thotë për Timoteun tek letra e dytë e Timoteut 1, 5:

sepse kujtoj besimin e sinqertë që është në ty, i cili më parë ishte te gjyshja jote Loide dhe te nëna jote Eunike, dhe jam i bindur se është edhe te ti.

Fëmijët ndjekin shembullin tënd. Këtu, tek Timoteu, kemi shembullin e mrekullueshëm dhe plot besim të nënës dhe të gjyshes së tij. Çfarë linje e

mrekullueshme besimi! Një linjë të tillë besimi mund të krijosh edhe ti me fëmijët e tu.

5. TË KESH KOHË PËR FËMIJËT

Eshtë e rëndësishme që prindërit t'u dhurojnë fëmijëve jo vetëm gjëra, por para së gjithash kohë nga koha e tyre. Me anë të kësaj, ne u japim të kuqtojnë se i duam. Por edhe këtu, nga të dyja anët, ka ndonjëherë teprime që nuk do të ishin të mira për fëmijët.

Në kapitullin e kaluar ne vumë re një fjalë nga Ligji i Përtëirë 11, 18-19 dhe u inkurajuam e u paralajmëruam që t'i mësonim gjithmonë fëmijët tanë që të flisnin për fjalën e Perëndisë dhe t'u tregonim atyre rrugën e vërtetë. Natyrisht që këtë mund ta bëjmë vetëm nëse kalojmë kohë me fëmijët. Ndonjë gjë e rëndësishme që ata duhet ta mësojnë, mund t'u shpjegohet ndonjëherë shumë më mirë gjatë një shëtitjeje, se sa kur u thua: "Ulu këtu në tavolinë. Kam diçka për të të thënë". Shumë gjëra mund t'u mësohen në këtë mënyrë fëmijëve.

Tani le të flasim për teprimet nga njëra anë apo nga tjetra:

Ne kemi njojur njëherë një burrë të dashur e plot besim, që kishte bërë shumë gjëra në mbretërinë e Perëndisë, por që u kushtonte shumë pak kohë fëmijëve të tij. Ai ishte vazhdimisht nëpër konferanca, shërbime dhe takime. Nga katër djemtë e tij, vetëm njëri e ndoqi Perëndinë. Fëmijëve dhe gruas së tij, ai u kushtoi shumë pak kohë. Unë e vlerësoj shumë atë burrë (ai ka vajtur tek Jezusi në qzell tashmë) megjithëse dështoi në këtë pikë. Por, përvèç kësaj, ka edhe teprime nga ana tjetër. Ne njohim familje, në të cilat fëmijët janë kaaq në qendër të vëmendjes, saqë ata zënë të gjithë kohën e lirë të burrit dhe të gruas. Sapo babai vjen nga puna në shtëpi, duhet të kujdeset për fëmijët, derisa ata të shkojnë në krevat. Ai duhet të luajë dhe të rrijë me ta, gjë që vazhdon çdo ditë. Në këtë mënyrë, fëmijët përcaktojnë automatikisht të gjithë ritmin e jetës së familjes. Gruaja e mbështet të

shoqin duke i mbajtur dhe ushqyer ditë për ditë fëmijët. Ata nuk mësohen që të jenë vetë kreativë, të merren me punëdore, të luajnë vetë, të vizatojnë apo të bëjnë gjëra të tjera. Ata janë plotësisht të përqendruar tek prindërit. Në këtë rast, pra, “t'u kushtosh kohë fëmijëve” taprohet dhe ata nuk përgatiten siç duhet për jetën. Le të bëjmë, pra, atë që është e mirë nga të dyja anët.

Fëmijët që Perëndia na ka dhënë duhet të mësojnë që edhe prindërit kanë nevojë për kohë për veten e tyre, kohë gjatë së cilës ata duhet të merren me gjëra të ndryshme. Nga ana tjetër ne duhet t'u kushtojmë kohë fëmijëve kur ata kanë nevojë urgjente për këtë, p.sh. kur kanë një lutje ose kur duan të na thonë ndonjë gjë. Ata duhet të krijojnë përshtypjen që prindërit janë gjithmonë të gatshëm kur unë kam nevojë për ndonjë gjë. Gruaja ime dhe unë, e patëm zgjidhur në këtë mënyrë këtë problem: çdo të shtunë bënim një ekskursion të vogël me fëmijët tanë. Në atë kohë ne kishim biçikleta të përdorura dhe me to shkonim nëpër rrethinat e mrekullueshme të Fürstenwaldit. Atje luanim së bashku “kuka-fshehtas”, futboll familjar, ku mama ja ishte portiere, apo lojëra të tjera. Fëmijët lodronin plot zjarr dhe ndiheshin shumë mirë. Ata ndiheshin mirë në dashurinë dhe praninë që ne u ofronim në këto ekskursione. Në këto raste mund t'u flitej lehtësisht edhe për gjëra të rëndësishme për jetën.

Fëmijët tanë kishin mësuar gjithashtu që, kur ne viheshim në shërbim të Jezusit ose angazhoheshim për të punuar për Perëndinë, nuk mund t'i kishin më për vete prindërit. Ata kishin mësuar në radhë të parë rëndësinë e këtij fakti dhe shumë shpejt filluan shërbimet bashkë me ne. Kështu, në përfundim të ekskursioneve tonë të të shtunave, në fund të ditës ne shkonim dhe vizitonim motra e vëllezër nga bashkësia të cilët nuk mund të vinin në shërbesat e së dielës për shkak se ishin të moshuar. Këto vizita na dhuronin shumë gëzim. Pra, mjaft shpejt, edhe fëmijët tanë kishin filluar që të ndihmonin në mbretërinë e Perëndisë.

Në mënyrë të veçantë, fëmijëve u pëlgente që kur ktheheshin nga shkolla, ta gjenin mamanë në shtëpi dhe t'i tregonin asaj gjithçka që kishin përjetuar gjatë ditës. Fakti që Perëndia na kishte dhuruar katër fëmijë, na bëri të qartë që gruaja ime duhet të rrinte në shtëpi dhe të kujdesej për edukimin e tyre.

Kur ajo vajti një herë në një shërbesë diku larg, megjithëse për një kohë të shkurtër, fëmijët e patën shumë të vështirë kur nuk gjenin asnje njeri ndërsa ktheheteshin në shtëpi. Ne e kuptuam menjëherë këtë dhe e ndryshuam situatën. Fëmijët ishin shumë të lumtur kur zbraznin zemrat e tyre të vogla tek mama e ngushëlllohesha e inkurajoheshin prej saj. Ngaqë kishim katër fëmijë, menjëherë kuptuam se nuk duhet t'i kushtonim asnjerit më shumë vëmendje se sa të tjerëve. Meqë duhej të bënte edhe punët e shtëpisë (atëherë nuk kishim as lavatriçë, as frigorifer dhe as gjëra të tjera që mund të na ndihmonin), gruas i duhej të kalonte shumë kohë me to, kështu që edhe fëmijët i mësuam që të ndihmonin. Nga kjo, ata mësuan që të ishin të gatshëm për të ndihmuar. Në fillim kishte edhe ndonjë kundërshtim, por megjithatë ata ndihmonin. Edhe duke bërë punët e shtëpisë mund të këndosh këngë shumë të bukura, apo të bësh biseda mjaft të këndshme.

6. TË DISKUTOSH GJITHÇKA SË BASHKU

E rëndësishme është që fëmijët tanë të na besojnë dhe që t'i edukojmë gjithmonë me sinqueritet përkundrejt nesh dhe Perëndisë. Kjo gjë nuk është e thjeshtë, por është një proces i tërë. Megjithatë, kur unë të kem fituar besimin e fëmijëve, atëherë do të jetë shumë e lehtë që të flas me ta edhe për gjëra të rëndësishme. Por, problemi është "Si?"

Siq është përmendur edhe më parë, në fillim të martesës, familja jonë nuk ishte në gjendje të mirë financiare. Rroga ime e parë, me të cilën duhet të mbahet gjithë familja, ishte shumë-shumë e vogël. Problemet që na dilnin për shkak të kësaj, i ndanim vazhdimisht me fëmijët, luteshim bashkë me ta dhe kështu, që të gjithë ishim në dijeni për gjithçka që përfjetonte familja. Kemi patur përvoja të paimagjinueshme se si fëmijët i lagonin këto probleme. Ata vetë e kanë parë se si Perëndia na ushqente dhe na mbante fort në dashurinë e Tij. I paharruar për ne dhe fëmijët tanë ka për të mbetur përfjetimi i mëposhtëm:

Ne ishim në fund të rezervave tona financiare dhe deri në rrogën tjetër duheshin akoma edhe shumë ditë, me fjalë të tjera, kjo do të thonte që ne nuk kishim më para për bukën e përditshme. Për këtë shkak, ne i thirrëm Perëndisë dhe të gjithë së bashku iu lutëm Zotit që të na ndihmonte. Situata ishte shumë dramatike, por fëmijët vazhdonin të luteshin bashkë me ne. Ndërkohë që situata ashpërsoshej gjithmonë e më tepër, në kuptimin që ne nuk kishim më absolutisht asgjë në shtëpi, ra zilja e derës. Ishte një motër nga bashkësia, të cilën ne e quanim hallë Lisi. Ajo na pyeti nëse mund të hynte brenda sepse donte të fliste për diçka të veçantë që kishte përjetuar. Filloi të tregonte që kishte trashëguar ca para nga një kushërirë e saj dhe për këtë shkak kishte hapur një llogari bankare. Sot kishte marrë fitimin nga banka dhe ndërsa po ecte rrugës, kishte pyetur Zotin se çfarë duhet të bënte me të dhjetën e atyre që kishte marrë.

Së pari kishte menduar t'i conte të dielën në bashkësi. Po vazhdonte të ecte kur kishte dëgjuar një zë të lehtë që i kishte thënë: "Jo, çoij tek familja Neumann!" Ajo kishte qenë shumë e çuditur dhe kishte thënë: "Zot, por unë nuk e di nëse familja Neumann ka nevojë për para!"

Por zëri në të, kishte qenë këmbëngulës: "Ofroja ato para, familjes Neumann!" Në fund ajo ishte dorëzuar dhe kishte thënë: "Në tregull Zot, atëherë po ia jap familjes Neumann të dielën në mëngjes!" Përsëri zëri kishte vazhduar: "Jo, sot!" Zëri kishte qenë kaq këmbëngulës saqë ajo ishte kthyer nga rruga dhe erdhi tek ne duke na lëshuar në dorë një shumë goxha të madhe parash. Ne adhuruam dhe falënderuam si kurrë ndonjëherë, ndërsa hallë Lisi gëzohej që kishte qenë një korriere e Perëndisë, sepse i treguam që nuk kishim patur më para dhe kishim arritur në fund të rezervave. Ajo ishte shumë e lumtur që kishte dëgjuar zérin e Perëndisë dhe ne ishim akoma më të lumtur që kishim përsëri para, të cilat do të na mjaftonin deri sa të merrnim rrogën. Lavdia i qoftë Perëndisë për të gjithë këtë ngjarje të vlefshme!

Ne si familje, pra, e kemi përjetuar Zotin e gjallë dhe kjo ka ndodhur herë pas here, kështu që fëmijët tanë nuk e kishin të vështirë të besonin në Të. Ata a kishin përjetuar Atë në mënyrë shumë praktike, në jetën e përditshme. Ne na dukej e rëndësishme që edhe lutjen e përdishtme ta bënim sa më tërheqëse. Në disa familje, për fat të keq, kur bëhet lutja, pas darke babai vë

Biblën mbi tavolinë, lexon një kapitull dhe pastaj thotë një lutje të gjatë. Unë besoj se kjo lloj lutjeje nuk është shumë interesante dhe tërheqëse përfëmijët. Unë do të këshilloja që prindërit të mendonin më tepër përtë bëre këtë në një mënyrë sa më fëmijërore. Ne p.sh. e bënim kështu:

Pasi fëmijët shkonin në krevat, ne rrinim për ca kohë në dhomën e tyre të gjumit. Gjatë kësaj kohe u tregonim atyre jo vetëm histori biblike, por edhe bisedonim përgjitarje të rëndësishme që ndeshnim gjatë jetës së përditshme. Një herë, kur një motër në bashkësi u martua me një jobesimtar, ne diskutuam se ç'thoshte Bibla përlidhje të tillë midis besimtarëve dhe jobesimtarëve, duke u thënë qartë se nuk lejohet që një besimtar të martohet me një jobesimtar. Ne folëm në mënyrë të detajuar me fëmijët përgjigjet negative që ka kjo dhe si rezultat, të katërt ata, u martuan me besimtarë. Në këtë kohë ne kemi biseduar edhe përtë tema të tjera. Përpinqeshim që të ishim të ndjeshëm përgjërat që u interesonin fëmijëve. Kur nuk kishim ndonjë temë të veçantë, merrnim një histori biblike dhe ua tregonim atyre, por pa e lexuar në Bibël. Në këto raste, gjithmonë përpinqeshim që të gjenim histori të cilat fëmijët tanë nuk i njihnin akoma. Meqë ata shkonin në shërbesën e fëmijëve dhe ngaqë e lexonin edhe vetë Biblën, t'u gjeje një histori të panjohur, nuk ishte e lehtë. Me kalimin e kohës ata e njihnin të gjithë Biblën shumë mirë. Por, megjithatë, ne gjithmonë u bënim supriza duke u treguar histori që nuk i dinin.

Për ne ishte shumë e rëndësishme që t'u tregonim gjëra të cilat do t'i bënin ata të shkathët më vonë në jetë. Vajzën e vogël ndonjëherë e zinte gjumi dhe ne e linim të flinte e qetë edhe kur në fund të kësaj kohe të përbashkët secili prej nesh lutej. Ndonjëherë fëmijët tanë e shfrytëzonin këtë kohë përtë bëre pyetje të ndryshme dhe kështu e shtynin orën e gjumit. Kur prindi është me përvojë e dallon menjëherë kur pyetjet janë serioze e të rëndësishme dhe përtë këtë shkak kërkijnë vërtet përgjigje, dhe kur pyetjet janë thjesht përtë shtyrë kohën e gjumit. Në këto raste, Ati do të të japë mençuri të madhe që të thuash dhe të bësh gjërat e duhura. Meqë fëmijët tanë gëzoheshin gjithmonë përtë këtë kohë, shpejt ata ishin të edukuar edhe me ndjenjën e kohës. Për këtë shkak, nuk kemi pasur probleme me hilet e fëmijëve përtë shtyrë kohën e gjumit.

Ne nuk themi që kjo eshtë mënyra më e mirë e përdorimit të kohës së lutjes. Kjo eshtë një ndër mënyrat e shumta që mund të përdoren. Mbështetë i dashur lexues, do të gjesh një mënyrë tjetër se si t'u flasësh fëmijëve të tu për Jezusin dhe se si t'i përgatisësh ata për jetën. Ndiq pra, atë mënyrë që të tregon Zoti. E rëndësishme eshtë që fëmijët të mësojnë t'i besojnë Jezusit.

Natyrisht që gjatë kësaj kohe ne u kemi treguar fëmijëve tanë se për shkak të Jezusit ata do të kenë edhe probleme; se të qenët i krishterë nuk ka vetëm ditë të bukura, por edhe të vështira, të cilat kërkojnë një çmim. Dhe në fakt e kishin një çmim. Fëmijët tanë patën ca probleme sepse nuk u anëtarësuan në organizatën e "Pionierëve" dhe as në "FDJ", si dhe nga që kishte disa mësues të cilët i linin me qëllim pas dore. Kështu, ne akoma mbajmë mend një nga këto ngjarje. Nga klasa e Kornelias dhe nga klasa paralele ishin tetë fëmijë që e përfunduan klasën e 8-të me nota shumë të mira. Në një festë të madhe që u organizua, këta fëmijë u prezantuan përparrë të gjithë prindërve. Edhe vajza jonë Kornelia, ishte një nga këta fëmijë. Por për të nuk ishte shumë e këndshme që të ishte një ndër ta. Ndërsa fëmijëve të tjerë iu dha një libër dhe një çmim në para nga drejtori dhe nga mësuesi për suksesin e arritur, Kornelia doli me duar bosh sepse nuk bënte pjesë në "FDJ". Kur festa mbaroi, ne e dërguam vajzën tonë me një trëndafil në dorë tek mësuesi i saj kujdestar, i cili në fakt ishte bëre shkak që ajo të mos merrte dhuratë dhe Konelia e falënderoi për gjithçka që ai i kishte mësuar gjatë vitit shkollor. Ne si prindër ishim disa metra larg dhe po shikonim. Për Konelian nuk ishte e lehtë dhe asaj iu desh të luftonte me veten, derisa më në fund vendosi të shkonte. Mësuesi i hapi sytë fort. Ai shikonte Kornelian, na shikonte ne dhe nuk dinte se çfarë të thoshte ose të bënte dhe e mbylli me një vërejtje të çastit e cila i dha fund edhe situatës së krijuar.

Fëmijët kishin mësuar në shtëpi që të duronin edhe disfavore për shkak të Jezusit. Ndoshta ata talleshin nga fëmijët e tjerë, sepse tregonin për Jezusin. Ndoshta shmangeshin sepse ecnin në mënyrë konsekiente me Jezusin dhe nuk bënин prapësira si të tjerët. Është vërtet bukur që fëmijët t'i mësojnë këto gjëra. Le t'i hedhim një sy jetës së Palit. Ai ishte në gjendje që të përbollonte edhe përjetime të tillë negative si thyerjen e anijes, goditje, gjuajtje me gurë, "të trajtohej si bandit" dhe shumë gjëra të tjera. Edhe në jetën e Jezusit mund të shohim shumë përjetime negative, si shpifje nga më të ultat. Me siguri

që ai kishte mësuar në shtëpi që t'i duronte të gjitha këto disfavore. Ne besojmë që Jezus Krishti do të vijë përsëri së shpejti dhe që ne jemi në ditët e fundit. Fëmijët tanë duhet të bëhen të fortë që të qëndrojnë pranë burrit apo gruas së tyre në këto ditë.

7. TË MOS PREFEROSH NJË FËMIJË MË SHUMË SE SA TJETRIN

Një ndër gabimet më të shpeshta është të preferuarit e një fëmije më shumë se sa të tjerët, kur Perëndia na dhuron më shumë se një fëmijë. Ne duhet të kemi shumë kujdes që të gjithë ata të marrin të njëjtën dashuri dhe përkushtim prindëror. Për këtë ka disa shembuj të veçantë biblikë që përshkruajnë pasojat negative të parapëlqimit të një fëmije. Këta shembuj fillojnë që në faqet e para të Biblës.

Tek Zanafilla 4, 1-10 na tregohet historia e Kainit dhe e Abelit. Kur Kaini lindi, (si i parëlindur) Eva dhe Adami ishin shumë të gëzuar. Emri Kain i përkthyer do të thotë: “Unë kam fituar një burrë me ndihmën e Zotit”. Kështu, Kaini ishte burrërori. Eva e thërriste emrin e tij me gëzim të madh. Më vonë, kur lindi Abeli, duket se prindërit nuk kishin më kaq gëzim sepse kuptimi i emrit të tij është “Frymë” ose “Frymëmarrje”. Në Bibël nuk tregohet se përsë ndodhi kështu. Kaini duhet të ketë qenë gjithmonë i pari dha natyrisht që ishte edhe më i preferuar. Pse? Sepse ai nuk mund ta duronte më që të ishte i dyti. Një ditë, të dy i ofruan diçka Perëndisë. Kaini ishte bujk dhe i ofroi Perëndisë frytet e fushës, kurse Abeli i ofroi nga të parëlindurit e tufës. Abeli solli më të mirën që kishte mundësi. Në letrën e Hebrejve na thuhet që ai solli një ofertë më të mirë nëpërmjet besimit. Kaini nuk mund të duronte që të ishte i dyti as në ofertë, kështu që u mbush me zili për vëllanë e tij. Perëndia e paralajmëroi para se të ndodhë vrasja dhe i tha që mëkat po përgjonte pas derës së tij. Për fat të keq ai nuk e dëgjoi dhe e goditi vëllanë e tij Abel. Pra, kjo vëllavrasje e parë është e lidhur me zilinë dhe është një tregues për preferencën e të parëlindurit Kain. Në këtë rast, prindërit bënë një gabim shumë të

rëndë.

Po kështu ndodhi edhe me Jakobin. Jakobi, me sa dimë ne, kishte dymbëdhjetë djem, nga të cilët preferonte Jozefin. Kur të gjithë vellezërit shkonin të punonin, ai a linte Jozefin në shtëpi. Për djalin e tij të preferuar kishte bërë edhe një veshje shumë të veçantë e me shumë ngjyra, duke e ngritur në këtë mënyre mbi të gjithë vellezërit e tjerrë. Preferanca ndaj Jozefit, e lidhur kjo edhe me një sjellje të pamatur të tij në raport me èndrrat e veta, i çoi vellezërit në urrejtje dhe më së fundi në shitjen tek egjiptianët. Edhe në këtë rast, babai Jakob ka mjaft faj. Megjithatë Zoti ka bërë diçka të mirë edhe nga ky edukim i gabuar nëpërmjet dashurisë. Por, kjo nuk do të thotë që edhe ne do të kemi privilegje po të preferojmë njérin nga fémijét tanë. Si rrjedhojë e gabimit që bëri me djalin e tij, për vite me radhë Jakobi pati vuajtje shpirtërore.

Akoma më i quartë është një shembull i tretë biblik. Këtu e kam fjalën për Adonijahun, djalin e Davidit. Tek letra e parë e mbretërve 1, 5-6 mund të lexojmë:

**Adonijahut, birit të Hagithit, i qe trtitur mendja, dhe thoshte:
“Do të jem unë mbret!”. Dhe gjeti qerre, kalorës dhe pesëdhjetë
njërej që të vraponin para tij. (I ati i tij (Davidi) nuk e kishte
qortuar kurrë në jetën e tij, duke i thënë: “Pse bën kështu?”.
Edhe Adonijahu ishte shumë i bukur dhe kishte lindur mbas
Absalomit).**

Mbreti i madh David kishte bërë gjëra jo të zgjuara në edukimin e fémijëve të tij të shumtë. Ai kishte preferuar Adonijahun dhe nuk e kishte qortuar kurrë për ndonjë gjë gjatë gjithë jetës së tij, thotë shkrimi. Pra, ai nuk i kishte vënë atij asnjë lloj kufiri. Adonijahu mund të bënte çfarëdo që të dëshironte. Ai mund të jetonte sipas mënyrës që mund të zgjidhë vetë. Një ditë prej ditësh ai kishte marrë ca komandantë ushtrie dhe ca përfërinj dhe ishte shpallur mbret duke kurdisur një komplot kundër të atit. Ai ë shpalli veten mbret të Izraelit. Më pas, mbretit David iu desh që të vepronte shumë shpejt, duke vendosur si mbret birin e tij Solomonin, me qëllim që të mos ishte Adonijahu i tillë.

Është gjë mjaft e rëndë që djali të ngrihet kundër babait që nuk e ka qortuar kurrë gjatë gjithë jetës së tij dhe të vetëshpallet mbret. Davidi pra, i përjetoi direkt në trupin e tij pasojat e rënda të edukimit të gabuar.

Këta shembuj na janë dhënë si paralajmërim, me qëllim që të mos bëjmë edhe ne të njëjtën gjë dhe të mos lejojmë preferenca të njërit prej fëmijëve tanë.

Çfarë bëjmë ne në familje kur njëri prej fëmijëve është i talentuar në mënyrë të veçantë, kur njëri prej tyre është më i bukur se të tjerët, kur një i llastohet më shumë mamasë ose një tjetër babait? A tregohemi edhe në këto raste të drejtë dhe i edukojmë të gjithë fëmijët njëloj, duke u dhënë të njëjtën dashuri dhe të njëjtën edukatë? Ky problem fillon kur vjen në jetë një fëmijë i dytë. Për sa kohë që është vetëm fëmija i parë, gëzimi është shumë i madh dhe prindërit janë të lumtur që e kanë atë fëmijë, sidomos kur kanë një fëmijë për të cilin janë lutur shumë, e kanë dëshiruar dhe kanë pritur shumë. Dhe ja ku pas ca kohësh vjen edhe fëmija i dytë. Kam vënë re që prindërit kanë një mori me fotografi të fëmijës së parë, ndërkohë që përfshinë e dytë dhe të tretë kanë shumë pak.

Është urdhër mençurie që ndërsa fëmija i dytë është gati për të ardhur, fëmija i parë të përfshihet në atmosferën e gëzueshme të pritjes familjare. Ne duhet që gjithë gëzimin ta përqëndrojmë në faktin që familja do të rritet. Mamaja mund ta bëjë vëllaçkon apo motërzen të ndihet i apo e lumtur për ardhjen e fëmijës së dytë dhe ajo mund ta largoje që në fillim zilin që mund të lindë. Mamaja mund ta sqarojë fëmijën që në fillim se ajo do të kalojë më shumë kohë me foshnjën që do të lindë sepse ai është i pafuqishëm dhe ta sqarojë fëmijën që edhe asaj apo atij në fillim i ka kushtuar më shumë kohë, dashuri dhe përkushtim. Kështu fëmija nuk do të ndihet keq kur të shohë që në fillim, të sapolindurit i kushtohet më tepër vëmendje.

Por, kur të bëhet më i madh, duhet të jetë e qartë që të dy fëmijët do të trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe asnjëri prej tyre nuk do të lihet pas dore apo të preferohet në ndonjë mënyrë. Fëmijët kanë një ndjenjë shumë të zhvilluar drejtësie dhe do ta vënë re menjëherë këtë. Le të jemi të mençur edhe në këtë pikë dhe t'i marrim seriozisht paralajmërimet biblike.



8. UDHËHEQJA NË SHTËPI

Po të studiosh Biblën, respektivisht pleqtë, peshkopët dhe diakonët, atëherë mund të shikosh që për zgjedhjen e tyre janë përdorur vetëm kriteret e udhëheqjes që ata kanë patur në jetë. Pra, faktet që tregojnë se si e ka organizuar jetën praktike kandidati që kërkon të bëhet Plak ose Dhjak, janë vendimtare. Vargu i mëposhtëm biblik, është marrë nga 1 Timoteu 3, i cili në Biblën time ka mbishkrimin “Për peshkopët”. Po të shikosh Veprat e Apostujve, peshkopët quhen Pleq. Në thelb pra bëhet fjalë për postin e Pleqve në bashkësi.

Tek 1 Timoteu 3, 4-5, karakteristikat e një Plaku përshkruhen si më poshtë:

... njeri që e qeveris mirë familjen e vet dhe i ka fëmijët të bindur me çdo lloj mirësjellje; (sepse në qoftë se dikush nuk di të qeverisë familjen e vet, si do të kujdeset për kishën e Perëndisë?).

Bibla, pra, thotë që vendimi varet nga shtëpia, nëse një burrë dhe baba do të bëhet Plak ose edhe Dhjak, sepse edhe për dhjakët kërkohet si kriter bazë për zgjedhje, cilësia për të drejtuar mirë shtëpinë dhe për të pasur fëmijë të bindur.

Për ta theksuar edhe një herë: Në shtëpi merret vendimi nëse unë jam në gjendje të mbaj përgjegjësi në mbretërinë e Perëndisë. Unë si baba duhet ta udhëheq mirë familjen time dhe të kujdesem që fëmijët e mi të jenë të bindur, përndryshe Fjala thotë që nuk është e mundur të mbaj përgjegjësi në mbretërinë e Perëndisë. Kjo e ngre të gjithë edukimin në një nivel shumë të lartë. Një shembull i shkurtër negativ: Në një bashkësi relativisht të vogël, që nuk kishte pastor por një udhëheqës bashkësie, ishte planifikuar një festë për fundjavë. U deshën shumë vende strehimi sepse do të vinin plot njerëz. Për këtë shkak, u shtrua kërkesa për vende të tilla. Udhëheqësi i bashkësisë tha kështu: “Unë nuk mund të marr asnje njëri në familjen time. Djali im ka thënë se nuk do të lejojë asnje që të shkelë tek ne!” Mua më duket vërtet tragjike që babai nuk ishte në gjendje ta bindte djalin që të lironë dhomën e tij për dy net dhe të shkonte në ndonjë dhomë tjeter



në shtëpi për të ndihmuar miqtë. Unë mendoj se ne duhet të mësojmë të reagojmë ndryshe. Në shtëpi, ne jemi ata që vendosim nëse udhëheqja e Perëndisë është e mundur apo jo. Zoti të ndihmoftë për të kuptuar këtë pike delikate dhe për të nxjerrë konkluzionet e duhura, që pastaj të mund të ndihmosh fëmijët të bëhen të bindur, në mënyrë që shtëpia dhe bashkësia e Perëndisë të drejtohen siç duhet dhe të udhëhiqen ashtu siç thuhet në Bibl.

Është gjë e bukur kur Perëndia të ka dhënë një djalë dhe mamaja është në gjendje që t'i thotë: "Sot babai është përgjegjës në bashkësi. Ai nuk ndodhet këtu." ose "Ai është në udhëtim në shërbim të Perëndisë për disa ditë. Gjatë kësaj kohe ti mund të jesh zëvendësuesi i tij, tek i cili mund të mbështetem dhe që më ndihmon duke më qëndruar pranë". Kjo do ta forcojë shumë imazhin e djalit dhe ai do të jetë krenar që mund të zëvendësojë të atin dhe të ndihmojë të ëmën, edhe pse ndihma mund të jetë në gjëra fare të vogla.

9. TË MËSOSH FËMIJËT TË MBAJNË PËRGJEGJËSI

Është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë të marrin përgjegjësi për detyra dhe punë të vogla në shtëpi. Në këtë mënyrë ne i mësojmë që të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e përgjegjësive. Natyrisht që të gjithë e dimë se sot është shkolla ajo që merr pjesën më të madhe të kohës edhe pas mësimit, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, kështu që duhet të jemi të kujdeshshëm se çfarë pjese duhet të zënë detyrat dhe punët në shtëpi. Edhe kur janë detyra të vogla dhe jo shumë të rëndësishme, fëmijët mësojnë të marrin përgjegjësi duke kontrolluar nëse gjërat janë kryer siç duhet. Për këtë shkak, fëmijët duhet që të kenë rregullisht ndonjë punë për të kryer në shtëpi, si p.sh. të pastrojnë dhomën e tyre, të rregullojnë krevatët, të fshijnë pluhurat, të mbajnë pastër këpucët, etj. Secili nga fëmijët tanë kishte një grup detyrash të përcaktuara qartë për të kryer, dhe ne ose i lavdëronim ose i paralajmëronim për mënyrën se si i bënin punët.

Punët e tjera ishin gjëra të vogla, jashtë detyrave të përditshme që kishin për të kryer rregullisht. Kështu, herë pas here, fëmijët donin të na tregonin se sa të fuqishëm ishin bërë dhe na ndihmonin duke mbajtur pesha kur ne kthehem nga pazari, ose kur donim të merrnim ndonjë gjë nga bodrumi. Në këto raste ne duhet të ishim shumë të kujdeshshëm që të mos i mbingarkonim, por nga ana tjetër edhe t'u bënim të qartë se sa shumë e çmonim ndihmën e tyre. Praktikisht, kjo do të thotë që t'i lësh të mbajnë aq sa e lejon mosha e tyre dhe pastaj t'i lavdërosh për punën e bërë. Fëmijët tanë donin që të demonstronin forcën e tyre edhe duke ndihmuar njerëzit e tjerë. Më kujtohet se si djali ynë, Andreas, e ka ndihmuar shumë herë një zonjë të moshuar, në katin e tretë, duke i çuar pa asnje shpërblim dru ose qymyr nga bodrumi. (Në Gjermaninë Lindore kishte pothuajse vetëm stufa me pllaka të cilat punonin me qymyr që sillej nga bodrumi.)

Po kaq e rëndësishme është edhe marrëdhënia me paratë e xhepit. Ne i mësuam fëmijët që t'i kursenin paratë. Nuk donim t'u jepnim shumë sepse pastaj ata nuk do të mësonin të çmonin vlerën e tyre, por nga ana tjetër donim që t'u jepnim mundësinë të ruanin njëfarë depozite me paratë e veta. Fëmijët tanë kishin shuma të vogla në dispozicion. E rëndësishme ishte që të mos i linim t'i harxonin kot paratë, d.m.th. të blinin gjëra që



ishin krejt të parëndësishme. Kur ti ta vësh re ketë gjë tek fëmijët e tu, atëherë duhet të ndërhysh. Nga ana tjetër, është e nevojshme që të ndihen të lirë për t'i përdorur paratë e tyre ashtu siç duan. Lavdëroji ata kur blejnë gjëra të mira **dhe** korrigoji kur duan që të blejnë vazhdimisht gjëra të parëndësishme.

Është mirë që të kesh ndikim në menaxhimin e parave të tyre edhe kur bëhet fjalë për shuma të vogla. Në jetë, nga fëmijët pritet që ata të mund të sillen mirë me paratë, si burra apo gra të ardhshëm,,me qëllim që të mos bien në borxhe, në varësi të bankave, apo të njerëzve të ndryshëm. Ne mund t'i ushtrojmë ata që në shtëpi se si të sillen me paratë. Bibla thotë se atij që është besnik në gjërat e vogla, do t'i jepen edhe gjëra të mëdha. Fusha e stërvitjes për ne si prindër është këtu në shtëpi dhe ne do të konstatojmë me gjësim se do të përgatisim fëmijë të gatshëm për të marrë përgjegjësi në martesë apo në familje. Është vërtet bukur që ti si prind të shikosh se si fëmijët e tu mësojnë të jenë të besueshëm e besnikë dhe mund të ndihmojnë në fusha të caktuara si në bashkësi, në martesë dhe në familje.

10. FAZAT NË JETËN E FËMIJËVE

Hyrje të shkurtra specifike për fazat e veçanta të jetës së fëmijëve

EDUKIMI I BEBEVE / FËMIJËVE TË VEGJËL

Është diçka e njohur dhe madje edhe vetë shkenca e ka vërtetuar që kontakti trupor ka një rëndësi të madhe për fëmijët. Për këtë shkak edhe infermieret në disa klinika e vënë foshnjën e sapolindur direkt mbi trupin e nënës ose ia japid asaj në dorë me qëllim që të lindë kontakti i menjëhershëm. Ky kontakt trupor, i lidhur me fjalë të buta, plot dashuri, është shumë i rëndësishëm për rritjen e fëmijës. Nëna ia prek faqen me përkëdheli, e puth, e ledhaton me dashuri në kokë, i merr dorën etj. Nëpermjet këtyre kontaktave trupore sinjalizohet: Unë të dua ty! Unë jam për ty! Unë të dua me gjithë zemër! Edhe në vitet e mëvonshme rëndësia e kontaktit trupor mbetet, megjithëse nuk është më kaq i nevojshëm sa në moshën e foshnjërisë. Edhe babai do t'i afrohet shumë shpejt foshnjës së sapolindur, me fjalë të émpla, me përkëdheli, me prekje, duke shprehur kështu dashurinë e tij për fëmijën. Megjithatë, përfat të keq, edhe në këtë fushë ka teprime të forta. Kështu p.sh. disa prindër i mbajnë foshnjat e tyre gjatë gjithë ditës në krahë. Që në mëngjes kur fëmijët zgjohen dhe deri kur flenë, ata i mbajnë në krahë duke i shëtitur nëpër shtëpi dhe nuk mund të bëjnë asnjë punë siç duhet derisa vogëlushin ta zërë gjumi. Kjo krijon një tepricë kontakti trupor. Edhe nervat e fëmijës së vogël do të sforcohen, sepse nuk qetësohen në mënyrë të natyрhshme. Kështu nuk do të plotësohet as nevoja e madhe që kanë foshnjat për gjumë. Kur mbahet gjatë gjithë ditës në krahë dhe shëtitet lart e poshtë, ai përjeton vazhdimit gjëra të reja dhe në këtë mënyrë nervat e tij influencoher shumë. Përfitimi që arrihet nëpermjet kontaktit trupor është shumë i vogël në krahasim me dëmtimet që shkaktohen nga ai. Edhe procesi i çlirimt të fëmijës nga e ëma do të jetë më i vështirë,

sidomos kur të shkojë në shkollë, ku mama ja nuk mund ta shoqërojë më. Po kështu, në kopsht, ai do të ndahet me shumë vështirësi nga nëna. Gjëja më e rëndësishme është që fëmija yt të ketë qetësinë e tij, gjumin e tij, që të mësojë të luajë vetëm, që të kryejë vetë lëvizje të vogla, që të shtrijë vetë duart në karrocë apo në krevat dhe të bëjë gjëra të tjera. Në fund të fundit, ne duam t'i edukojmë fëmijët tanë që të janë të pavarur dhe me fantazi.

Natyrisht, nuk ka vargje biblike që të na shpjegojnë se si të reagojmë ndaj të qarave të fëmijës, apo si t'i jepet gjii. Këtu duhet thjesht të përdorim parimet biblike, sipas kuptimit. Siç e kemi shpjeguar tashmë në kapitullin tre të pjesës së parë, duhet që së pari të mësohet bindja. Nga ky parim themelor dalin konkluzione edhe për detajet ndërkokë që mund të nxjerrim edhe përgjigjen se çfarë duhet të bëjmë kur qan fëmija ynë. Çdo nënë e re, shqetësitet kur foshnja qan. Ajo do të vrapojet tek karroca apo tek krevati dhe do të shikojë se çfarë ka fëmija. Një nënë me përvojë është menjëherë në gjendje të dallojë nëse ai qan sepse është lënë pas dore apo sepse ka vërtet ndonjë problem. E qara është krejt ndryshe kur fëmija ka ndonjë problem fizik apo ankohet. Nëna me përvojë e dallon menjëherë kur atij i dhemb ndonjë gjë dhe qan për këtë shkak. Ajo që vihet re aty-këtu tek fëmijët e vegjël, është që ata shqetësohen shpesh nga gazrat. Nëna e mençur mund t'u vijë menjëherë në ndihmë duke u bërë masazhe në bark.

Për fat të keq, edhe në këtë fushë mund të ndodhë një zhvillim jo i mirë kur babai apo mama vrapojnë me nxitim tek krevati i fëmijës sapo ai qan, e ngrenë lart atë dhe përpinqen që ta qetësojnë duke i folur ëmbël dhe duke e përkundur. Fëmija mëson shumë shpejt që sa herë të qajë, prindërit do të vrapojnë me nxitim tek ai dhe kështu fillon që ta shfrytëzojnë këtë mundësi për t'i mbajtur ata të lidhur me veten. Për këtë shkak, motra dhe vëllezër të dashur, jini të zgjuar edhe në këtë drejtim.

Një doktoreshë me përvojë i tha njëherë gruas sime: "Lëre një herë fëmijën që të qajë pak. Kjo është një ndër punët e tij, përvèç rropatjes, të pirit dhe të ngrënët." Në këtë drejtim, mund ta mësojmë fëmijën dhe t'i tregojmë mënyra të veçanta sjelljeje; duke mos reaguar ndaj çdo lloj të qare, qoftë dhe duke e lënë të vazhdojë për 10 minuta, pa menduar se po i bëjmë diçka të keqe. Fëmija duhet të mësojë që të rrije edhe vetëm, përndryshe automatikisht do të fillojë që të luajë me kohën e të qarave, në fillim të

pamotivuara, dhe të kontrollojë të tjerët apo të merret vetë me punë. E rëndësishme është që te fëmija të mos krijohet përshtypja që sa herë të qajë, prindërët do të vrapojnë tek ai.

Natyrisht që bëhet fjalë për diçka tjeter kur fëmija është i sëmurë dhe ankohet për probleme fizike. Në këtë rast e qara e fëmijës ka një kuptim krejt tjeter dhe mamaja duhet të reagojë për çdo të qarë të fëmijës. Një fëmijë i shëndetshëm, ama, mund të lihet të qajë edhe për një kohë të gjatë.

Një temë shumë të nxeh të zgjon pyetja: Fëmija duhet të ushqehet me orar apo sipas nevojës? Të ushqyerit e fëmijës është një ndër gjërat më të bukura që ka dhënë Perëndia, sepse nëna nuk do ta ketë më kurrë kaq pranë fëmijën; si kur i jep gji, ashtu edhe kur e ushqen me mënyra të tjera. Në këtë kohë nëna e shikon fëmijën me kujdes, fëmija nënën gjithashtu, ndërsa nëna mund të përjetojë kënaqësinë dhe gjëzimin e fëmijës. Gjatë të ushqyerit, midis të dyve ndodhin shumë gjëra të bukura; jo vetëm që shkëmbohen fjalë të embla, por ka edhe kontakte fizike. Është e mahnitshme ajo që ka bërë Perëndia. Qumështi i gjirit ka temperaturën e duhur, përbërjen e duhur. Gjithçka është rregulluar në mënyrë të përsosur nga Krijuesi ynë i mrekullueshëm.

Në kohën e Republikës Demokratike Gjermane, ishte një periudhë kur nënave u këshillohej që të përdornin ushqim artificial sepse ai gjoja ishte më i sterilizuar dhe me përbërje më të mirë, kështu që duhej të hiqnin dorë nga të ushqyerit me gji. Qëllimi i gjithë kësaj ishte që nënati të shkonin më shpejt në punë. Në atë kohë i thashë gruas sime: "Kjo që thonë ata është budallallëk. Ajo që ka bërë dhe krijuar Perëndia është shumë e mirë. Ne do të qëndrojmë tek ajo që na ka dhënë vetë Perëndia." Pastaj gruaja i ushqeu të gjithë fëmijët me gji, për aq kohë sa ishte e mundur. Unë e di që ka shumë të krishterë që janë pro të ushqyerit të fëmijës sipas nevojës. Ndër të tjera, argumenti i tyre kryesor është që trupi e di se kur i duhet ushqim dhe si rrjedhim, kur fëmija qan, ai ka një nevojë të tillë. Ne vetë nuk e ndjekim këtë parim sepse nëse çdo njeri do të hante sa herë të kishfe ura, atëherë në tokë do të kishte shumë njerëz me mbipeshë. Personalisht jemi thellësish të bindur se të dhënët e gjirit duhet të bëhet me orar dhe sipas parimeve biblike t'i përgjigjet "të mësuarit të bindjes". Pse? Ka një varg arsyesh për

këtë, si p.sh. kush e percakton ritmin e fëmijës, vetë fëmija apo prindërit? Kush thotë se kur do të hahet dhe kur jo, fëmija apo prindërit? Ne besojmë se prindërit e kanë përgjegjësinë për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve.

Stili i botës thotë që të jetojmë sipas parimit të kënaqësisë, pra fëmijët të thonë se kur duan të hanë dhe ne t'u plotësojmë çdo dëshirë. Ky është një mendim që ka zënë vend edhe në edukimin e fëmijëve. Në fund të fundit, do t'i përgjigjemi me të ngrënë apo me qumësht pakënaqësisë, qarjes së fëmijës dhe kështu ai do të qetësohet. Në fakt ndodh një keqpërdorim i mundësisë së dhënë nga Perëndia për të qetësuar fëmijën nëpërmjet gjirit. Në qoftë se do t'i jepnim për të ngrënë kur ndihet i pakënaqur dhe qan, kjo mund të kishte si rrjedhojë që fëmija të bëhet i dhënë pas ushqimit. Ja një shembull për këtë: Njëherë, bashkë me shumë të krishterë të tjerë, ishim ulur në një kafene në rrugë; po pinim një filxhan kafe dhe po hanim një copë ëmbëlsirë. Papritur, diku pak më larg, ra në tokë një gotë apo një objekt tjeter që bëri goxha zhurmë. Një fëmijë në karrocë, u zgjua i trembur nga kjo zhurmë dhe filloi të qante. Mamaja vrapi tek ai, e mori dhe e vuri në gjii në mes të rrugës, jo sepse foshnja kishte uri, por sepse donte që ta qetësonte dhe ta ndihmonte për të larguar frikën. Sigurisht që ky efekt do të mund të arrihej edhe nëse nëna do të kishte përdorur fjalë të ëmbla apo ndonjë masë tjeter për të qetësuar fëmijën.

Ne vetë patëm vendosur për ritmin 4-orësh që e këshillojnë shumica e mjekëve. Kjo do të thotë që fëmijës do t'i jepej gjii çdo 4 orë. Më vonë ndodhi që duhej të ishim shumë të përpiktë me orën. S'kam për ta harruar kurrë kur një ditë, vajza jonë e madhe, Kornelia, e cila ishte në karrocë, filloi të qante. Unë pashë orën dhe ajo tregonte pak para 5-ës. Në 5:00 ishte orari kur ajo do të pinte gjii. Stomaku vihet shumë lehtë në punë sipas orarit duke e marrë dhe përpunuar më mirë ushqimin. Natyrisht që në rast sëmundjeje apo në ndonjë rast tjeter, mjeku mund të këshillojë që ushqimi të shpeshtohet në çdo dy orë, sepse trupi i sëmurë nuk është në gjendje që ta përpunojë të gjithë ushqimin menjëherë. Në këto raste, patjetër që do të shmangesh nga rregullat.

Për ta theksuar edhe një herë: ne ngulim këmbë që të dhënët e gjirit duhet t'i përgjigjet parimit të të mësuarit të bindjes dhe duhet të jemi ne që do t'i sinjalizojmë fëmijët tanë se kur do të hanë. Kjo do të shërbejë edhe për më vonë, që të jemi ne ata që do t'u thonë fëmijëve tashmë të rritur, se kur të

hanë dhe kur të presin derisa të vijë koha që të ulemi në tavolinë, pasi mamaja të ketë përgatitur drekën apo darkën.

EDUKIMI I FËMIJËVE MË TË RRITUR

Në kapitullin 9, u prek tashmë tema se si t'i mësojmë fëmijët të marrin përgjegjësi dhe si të mbajnë rregull në gjërat e tyre. Mbajtja e rregullit është veçanërisht e rëndësishme për ta: Ku do t'i vendosin këpucët? Ku do t'i vendosin veshjet kur flenë ose kur ngrihen? Ku janë objektet e tyre të shkollës? T'u mësosh fëmijëve rregullin që në vogëli, është një ndër gjërat më kryesore për familjen prindërore.

Në një moshë më të rritur, është e rëndësishme që t'i sqarojmë fëmijët edhe seksualisht. Është zgjuarsi që t'i informosh ata përpara se t'i mësojnë këto gjëra nga fëmijët e tjerë në trugë. Se kur është koha e përshtatshme, këtë duhet ta dallosh vetë. Por, kjo gjë nuk duhet bërë shumë vonë. Mbase është në varësi të të kuptuarit të tyre që ta ndash këtë në etapa të vogla dhe me tritjen e fëmijës t'i thuhen gjithmonë e më shumë gjëra në mënyrë më të qartë.

Natyrisht që mamaja duhet ta sqarojë në kohë vajzën, me qëllim që të mos lindë ndonjë problem kur ajo të ketë periodat. Nëna e gruas sime, për fat të keq, nuk e bëri këtë dhe kur ajo pati periodat për herë të parë mendonte se do të vdiste për shkak të gjakut që rriddhe nga trupi i saj. Por, edhe më vonë, mamaja duhet ta përgatisë vajzën me dashuri dhe me kujdes për marrëdhëniet seksuale, për pastërtinë dhe për gjëra të tjera. Të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe babai me djalin, kur tensionet seksuale fillojnë që të aktivizohen në trupin e tij. Madje, është më mirë që ai ta bëjë këtë gjë përpara kësaj, me qëllim që djali të dijë se si të sillet me këto ndryshime të trupit të tij dhe më vonë ta përgatisë edhe për martesën. Për fat të keq edhe prindërit e mi nuk më sqaruan mua. Kështu, shumë gjëra për seksualitetin unë i kam mësuar në një mënyrë të pakëndshme, nga qarqe të tjera. Duhet që ne si baballarë t'i sqarojmë vetë djemtë tanë që na ka dhënë Perëndia; të

flasim me ta për masturbimin dhe çështje të tjera seksuale, me qëllim që ata edhe këtu të shikojnë siç duhet dorën plot dashuri të Krijuesit.

Një pikë tjetër është edhe ndjekja e shërbesave të organizuara për fëmijët në bashkësi. Në kohën e zhvillimit, veçanërisht, kjo mund të sjellë irritime tek fëmijët dhe papritur ata nuk duan të vijnë më në shërbesa. Çfarë duhet të bëjnë prindërit në këto raste? A duhet që ata të dorëzohen dhe t'i lejojnë fëmijët të qëndrojnë në shtëpi, apo duhet të ngulin këmbë që të shkojnë bashkë me ta në bashkësi? Gruaja ime dhe unë ramë në një mendje, që për sa kohë që fëmijët qëndronin nën autoritetin tonë prindëror, t'i shpienim gjithmonë në bashkësi për të marrë Fjalën e Perëndisë. Ne i kemi fëmijët vetëm për një kohë të caktuar dhe pastaj Perëndia ka për të na pyetur se çfarë bëmë me këtë kohë. Duke u nisur nga ky gjykim, vendosëm që t'i merrnim gjithmonë me vete fëmijët në shërbesë edhe atëherë kur ata nuk kishin dëshirë. Një ditë prej ditësh, djali ynë i madh më njoftoi që nuk do të vinte më me ne, në bashkësinë në të cilën shkonim në atë kohë për shërbesën e së dielës. Ngulëm këmbë që ai të vinte me ne dhe më në fund erdhi pa shumë dëshirë, duke na thënë që sapo të mbushte 18 vjeç nuk do të vinte më kurrë atje. Me dashurinë e Tij të madhe, Perëndia bëri që të kthehej tek Ai para se të mbushte të tetëmbëdhjetat dhe pastaj, natyrisht që vinte në bashkësi jo vetëm të dielave, por edhe gjatë javës.

Para ca kohësh isha ftuar në një grup të krishterësh ku trajtohej tema nëse duhet t'i marrim fëmijët me vete në shërbesë apo jo. Disa pjesëtarë të grüpuit që diskutonin, ishin të mendimit se nuk ndihmonte për asgjë ardhja e fëmijëve në bashkësi për shkak të prindërvë, nëse ata nuk e kishin dëshiruar vetë një gjë të tillë dhe për këtë shkak nuq ishin të motivuar. Për këtë, unë i pyeta prindërit nëse duke i lënë fëmijët e tyre në shtëpi, para televizorit, ata do të kishin më tepër shanse për t'u kthyer tek Perëndia. Pas kësaj pyetjeje ra një heshtje e thellë në grup dhe pastaj i gjithë diskutimi u kthye nga drejtimi tjetër, pikërisht në atë që prindërit, për sa kohë që fëmijët qëndrojnë nën autoritetin e tyre, duhet të marrin edhe autoritet shpirtëror mbi ta dhe t'i sjellin pranë Fjalës së Perëndisë, sepse vetëm duke marrë Fjalën e Perëndisë, ka mundësi që të merret një vendim për të ndjekur Jezusin. Të gjithë fëmijët tanë e pranuan Jezusin para se të bëhen 18 vjeç dhe sot e kësaj dite vazhdojnë të ecin me Zotin. Perëndia do të të pyesë një herë: "Çfarë bëre ti në kohën kur t'u dha përgjegjësia shpirtërore?"

Sot, të gjithë fëmijët tanë janë të mëdhenj dhe përgjegjësia shpirtërore tani është në duart e tyre, por ne vazhdojmë që të lutemi çdo ditë për ta. Si përgjegjësi shpirtërore tani kemi detyrën për t'u lutar çdo ditë në mënyrë intensive dhe të mos ngatërrohemi në punët brenda martesave të tyre. Ne kemi vendosur që të mos jemi njerëz që ndërhyjnë në punët e të tjerve apo t'u diktojmë atyre se çfarë duhet të bëjnë. Megjithatë, jemi shumë mirënjohës kur ata na pyesin dhe na kërkojnë këshilla, gjë që ndodh mjaft shpesh. E konsiderojmë si një dhuratë të Perëndisë këtë marrëdhënie të re që kemi krijuar.

Perëndia do të ndihmojë edhe ty për të qenë konsekuent. Një fëmijë në moshë të re nuk e di akoma me saktësi se çfarë është e mirë për të dhe çfarë jo. Prandaj, jepi atij atë që ty të duket e mirë, atë që ke mësuar në shkollën e Perëndisë dhe atë që të duket e rëndësishme. Të gjithë ata që kanë pikëpamje të tjera, qoftë komuniste apo islame, do të vënë re se fëmijët e tyre do të njojin më mirë atë që prindërit vlerësojnë. Një komunist p.sh. do të përpinqet që t'i bëjë fëmijët e tij të mendojnë në mënyrë komuniste dhe do t'i edukojnë ata me këtë frymë. Një mysliman do të përpinqet që edhe fëmijët e tij të edukohen sipas besimit mysliman dhe të besojnë tek Allahu. Kjo është diçka krejt normale. Secili përpinqet që t'i japë fëmijës së tij atë që ai e mban për më të mirë. Për këtë shkkak jepi edhe ti fëmijës tend atë që ke përjetuar si më të mirë; pra Jezus Krishtin.

Kur fëmijët e tu të janë rritur ca, atëherë do të ketë një fazë ku ti nuk do të jesh më babai edukues apo nëna edukuese, por më tepër një shok apo një shoqe për ta. Kjo periudhë nuk është shumë e lehtë për t'u trajtuar, sepse ti ke mbajtur përvite me radhë përgjegjësi përmirëqenien e tyre shpirtërore dhe fizike. Por, në një moshë të caktuar, ti do t'i ndihmosh fëmijët e tu shumë më tepër dhe do t'i drejtosh më lehtë drejt pavarësisë nëse do t'i trajtosh ata si shokë apo si shoqe. Kjo do t'u pëlqejë shumë dhe ata do të kenë një besim të thellë tek ti si nënë apo si baba duke t'i drejtuar ty të gjitha pyetjet që u lindin. Kjo është një fushë tjetër për të mësuar dhe unë kam vënë re se shumë prindëri e kanë të vështirë që të fillojnë të mendojnë ndryshe kur fëmijët arrijnë në këtë fazë. Mendja dhe zemra fillojnë të përplasen në këtë kohë dhe nuk janë vetëm fëmijët ata që do të mësojnë gjëra të reja, por edhe prindërit. Në shkollën e Perëndisë ne mund të

provojmë që jemi të aftë për të mësuar dhe kjo për hir të dashurisë që kemi për fëmijët tanë, për ata që na i ka dhënë vetë Perëndia. Tí ke gjithmonë nevojë për Shpirtin e mirë të Shenjtë që është një ndihmës në çdo situatë, edhe në edukimin e fëmijëve.

Ekzistojnë edhe rregulla bazë që duhen mbajtur parasysh dhe që duhet të ndiqen, por shumë situata do t'i zgjidhësh me anë të mençurisë që do të të japë Zotin.

Unë nuk mund të harroj se si një herë, gruaja ime e ka përjetuar një orë të tillë të Perëndisë, kur nipi ynë i vogël, Johanesi, që jeton në të njëjtën shtëpi me ne, ishte plot mendime ziliqare. Gruaja kishte blerë nga automati, një lodër të vogël për motrën e tij, Elisabetën. Pas saj e kishte radhën Johanesi. Ai tha se donte diçka tjetër që ishte shumë më e shtrenjtë. Kur ime shoqe i kishte thënë: "Jo, kështu nuk ka; ti ose do të marrësh të njëjtën lodër, me të njëtin çmim, ose nuk do të marrësh asgjë!" ai, i mërzitur, kishte hequr dorë fare dhe ishte pushtuar nga një zili e thellë. Kur më vonë, gruaja e kishte bërë që të fliste dhe e kishte pyetur: "Johanes, ti tani je ziliqar për motrën tênde?", ai kishte thënë papritur: "Gjyshe, unë nuk dua që të jem ziliqar, por nuk mundem!" Në atë kohë ai ishte rreth 4 vjeç. Ime shoqe u mendua pak se çfarë të bënte dhe pastaj i tha: "Johanes, unë do të të tregoj tani një histori, historinë e Kainit dhe të Abelit, pastaj ne do të lutemi së bashku dhe ti nuk ke për të qenë më kurrë ziliqar!" Në fund, ata u lutën seriozisht. Johanesi kërkoi falje për zilinë e tij. Shpirti i Shenjtë erdhë dhe e ndihmoi djalin e vogël. Kështu, qëndrimi i tij prej ziliqari ndyshoi plotësisht. Tani ai mund të gëzohet kur motrës së tij i dhurojnë ndonjë gjë dhe kur e ëma i thotë: "Këtë herë do t'i blejmë Elisabetës një copë për fustan. Herën tjetër e ke ti radhën." Ai gëzohet me gjithë zemër. Perëndia ka dhënë hir që edhe në këtë pikë gjyshja ishte pranë tij. Ajo e vuri re këtë ves nga i cili Perëndia donte ta pastronte jetën e tij dhe ne jemi shumë të lumtur që ndodhi kjo gjë. Lavdia i qoftë Perëndisë!

PËRFUNDIM

Ajo që na prek në mënyrë të veçantë kur mendojmë për fëmijët, janë këto fjalë nga Psalmi 112, 1-3 në Bibël:

Haleluja. Lum njeriu që ka frikë nga Zoti dhe gjen një gëzim të madh në urdhërimet e tij. Pasardhësit e tij do të jenë të fuqishëm mbi tokë, brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar. Në shtëpinë e tij ka bollëk dhe pasuri dhe drejtësia e tij vazhdon përfjetë.

Kur kemi parë probleme në të kaluarën e fëmijëve tanë, gjithmonë i jemi referuar këtij psalmi dhe sidomos vargut 2: “**...brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar.**” Dhe ne i kemi thënë Perëndisë: “Zot ne e shikojmë që tani për tani nuk ka ndonjë bekim në këtë fushë. Zot, të lutem, bëj ndonjë gjë! Të ke thënë që fëmijët e të drejtëve do të jenë të bekuar. Ne nuk të lëmë; ne mbahemi fort tek Fjala Jote dhe e shpallim atë edhe në këtë situatë.” Dhe Zoti i ka dëgjuar gjithmonë lutjet. Haleluja! Lavdia i qoftë Atij! Ne duam të të inkurajojmë që t'i vendosësh fëmijët përballe Fjalës së Perëndisë. Natyrish që Zoti pret që gjérat të cilat mund t'i bësh vetë, t'i bësh. Por Ai gjithashtu pret që ti të kesh besim për fëmijët e tu; që t'i besosh Atij për rrugën e zhvillimit të fëmijëve që të janë besuar. Në qoftë se ti jeton sipas parimeve biblike të Perëndisë, atëherë Shpirti i Shenjtë do të jetë ndihmësi yt, për të edukuar fëmijët e tu në mënyrë të mirë, sipas parimeve biblike. Zoti qoftë me ty dhe Ai do të jetë. Amen.

DËSHMI PERSONALE (NGA KIRSTIN GROSS)

Kur unë isha shtatzënë me fëmijën e parë, si çdo grua që bëhet nënë për herë të parë, kam kërkuar këshilla lart e poshtë. Për fat të keq, konstatova që kishte mendime të ndryshme për dhënien gjii si dhe për edukimin e fëmijës. Madje edhe ndër vetë të krishterët, kishte mendime shumë të kundërtë. Gjithashtu, librat e shumtë pedagogjikë, jo vetëm që nuk më ndihmuani, por më bënë akoma edhe më të pasigurt dhe më konfuze, sepse ata ishin mbushur me mendime humaniste.

Kështu unë fillova të orientohem sipas Fjalës së Perëndisë dhe të kërkoja në Bibël se çfarë thoshte Perëndia për këto tema, sepse në fund të fundit Ai është Ati nga i cili vjen çdo ndjenjë atësie dhe Ai ka shumë fëmijë nga të gjithë fiset dhe kombet e botës. Unë zbulova shumë vargje sidomos tek Fjalët e Urta, të cilat e lidhnin edukimin e fëmijëve jo vetëm me dashuri por edhe me disiplinim dhe me faktin që ne vetë si prindër mbajmë përgjegjësi nëse fëmijët tanë do të shpëtohen nga "vdekja" (Fjalët e Urta 23,13-14). Por, si duhet t'i zgjidhja detyrat e shumta si bashkëshorte dhe si nënë në jetën e përditshme. Në letrën e Titit 2, 3-5, Pali thotë që gratë më të vjetra duhet të këshillojnë më të rejt që të duan burrat dhe fëmijët e tyre. Po ku ta gjej një grua të tillë që të ketë një frikë plot nderim ndaj Perëndisë?

Përparrë se të lindte djali ynë, patëm privilegjin që të njihnim Eckhard dhe Christel Neumann në bashkësinë tonë. Ata mbanin një seminar mbi martesën dhe edukimin e fëmijëve. Ndër temat e shumta që ata kishin zgjedhur për të folur, kishte edhe një pjesë të vogël për dhënien e gjirit sipas një ritmi të rregullt. Mua dhe burrit tim, kjo mënyrë e dhënieve për të pirë foshnjës sonë, jo vetëm që na u duk logjikisht e realizueshme, por na pëlqeu së tepërmë. Kështu, ne vendosëm së bashku që të ecnim sipas këtij rregulli. Në Psalmin 22, 10 thuhet që dhënia gjii i jep një ndjenjë besimi foshnjës. Unë dua të inkurajoj çdo nënë që t'i japë gjii foshnjës së saj për aq kohë sa ka mundësi.

Në zemër kisha një dëshirë të madhe për t'i dhënë vetë gjii foshnjës sime të parë, por për fat të keq dolën shumë probleme me këtë. Pas një lindjeje të komplikuar, na u desh që fëmijën ta çonim në një spital tjetër, rrëth një



gjysmë ore me makinë larg nga shtëpia jonë. Megjithatë unë nuk u dorëzova dhe brenda meje ishte rritur një dëshirë akoma më e madhe për t'i dhuruar këtë besim fëmijës tim nëpërmjet dhënies gjii. Më vonë, pata mundësi që të tre fëmijët e tjerë t'i ushqëja me qumësht gjiri për 8 muaj me radhë, madje me shumë përkushtim dhe gëzim.

Fëmijët janë një dhuratë e Perëndisë (psalmi 127, 3), kështu që edhe ne duhet t'i shikojmë dhe t'i pranojmë ata si të tillë. Pikërisht në këtë kohë, kur të qenët nënë dhe amvisë po del gjithmonë e më tepër nga moda e madje edhe përcmohet shpesh, duhet të jemi krenarë që po përbushim vullnetin e Perëndisë. Kjo “thirrje” duhet që të marrë një vlerë të re në zemrat dhe në shoqërinë tonë, sepse fëmijët kanë nevojë që t'u kushtojmë kohë dhe dashuri.

Megjithëse kisha një jetë profesionale shumë të suksesshme, në mënyrë krejt të vetëdijshme unë e lashë karrierën, për të qenë në dispozicion të fëmijës dhe të burrit tim. Edhe në qoftë se “qielli nuk do të bashkohet me tokën”, përsëri e di që do të mund të kem fëmijë të shëndetshëm në shpirt dhe në zemër si edhe një familje të shenjtëruar - këtë e premton Fjala e Perëndisë.

(

Nga misioni "Joshua" janë hedhur gjithashtu në qarkullim studimet e shkurtra biblike që vijojnë:

1. Dishepullimi (Eckhard Neumann)

Çdo tē thotë tē jesh dishepull i Jezusit dhe si mund tē bëbesh i tillë?

2. Pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë (Eckhard Neumann)

Si mund tē mbushesh me Shpirtin e Shenjtë.

5. Pagëzimi me ujë (Matthias Hütt)

Përse, pér s'qëllim? Shpjegime biblike rreth pagëzimit me ujë.

6. Shpirtrafituesi (Larry Lea)

Rreth domosdoshmërisë pér tē fituar njerëz pér Jezusin.

7. Tē njohësh Perëndinë (Russ Doty)

Autori e fton lexuesin që tē kërkojë një marrëdhëniet tē ngushtë me Perëndinë.

8. Martesa dhe Familja (Christel dhe Eckhard Neumann)

Këtu transmetohet përvoja e vlefshme e 38 viteve martesë tē autorëve si dhe përvoja e krijuar nga shumë biseda rrëth martesës dhe familjes.

9. Shpëtimi dhe Rilindja (Cinfried Rudloff)

Ky studim i shkurtër ka pér qëllim që t'u bëjë tē qartë njerëzve dashurinë e Perëndisë.

10. Miku im, Shpirti i Shenjtë (Horst Çeniger)

Këtu Shpirti i Shenjtë i sillet kaq pranë lexuesit, saqë nga kjo lind malli pér tē jetuar edhe në këtë lloj shoqërie.

11. Tē Ardhurat (Markus Rex)


Në këtë studim, autor i tregon qartë dhe në mënyrë tē peshuar se si mendon Perëndia pér financat dhe mirëqenien tonë. Perëndia dëshiron tē na bekojë, me qëllim që edhe ne tē jemi një bekim.

(

ECKHARD NEUMANN, datëlindja 1937, i martuar që më 1956 me Christel. Së bashku kanë 4 fëmijë, 4 nuse e dhëndurë dhe 10 nipër e mbesa. Ata janë udhëheqës dhe themelues të misionit të krishterë "Joshua" në Berlin.

Perëndia e ka përdorur shërbimin e tij për të themeluar një numër të madh bashkësisë të reja. Nëpërmjet shkollave biblike dhe atyre për bashkëpunëtorë, janë sfiduar shumë udhëheqës për të ecur me guxim në mbretërinë e Perëndisë.

Bashkë me gruan e tij, ai është aktiv në udhëtime-shërbime mësimore nëpër bashkësi të ndryshme.



Perëndia e ka porositur çdo të krishterë që t'i edukojë fëmijët e tij sipas fjalës së Perëndisë dhe t'i bëjë ata njerëz të shkathët në jetë. Shumë këshilla nga praktika, i jepin ndihmë lexuesit se si të sillet me fëmijët e tij dhe se si t'i trajtojë ata. Thëniet biblike janë një thesar për të shjuar suksese të bukura.